

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5463  
E shtunë, 28 prill 2018  
çmimi 0.40 €

## Meja, çmimi që Kosova e pagoi për liri

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHYQYRI HAXHA

FAQE 4-5

## Telekomi nuk duhet të privatizohet pas gjithë këtij degradimi

- Telekomi mund të shpëtojë nga falimentimi
- Nëse i hyj garës për kryeshef të Telekomit nuk do të pranoj të bëhem vegël e askujt

Ish-kryeshefi i Postës dhe Telekomit të Kosovës, Shyqyri Haxha, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka folur për situatën e krijuar në këtë kompani. Ai ka thënë se Telekomi mund të shpëtojë nga falimentimi dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim. Haxha ka theksuar se Telekomi nuk duhet të privatizohet pas gjithë këtij degradimi që i është bërë. "Kjo kompani duhet të ristrukturohet, të kthjelllet, t'i ngrihet vlera, pastaj të shqyrtohen mundësitë e privatizimit", ka thënë Haxha.



### AKTUALE

#### PO, KOSOVA ËSHTË DJEP I KRIMEVE SERBE!

SHKRUAN:  
JAKUP KRANSIQI



#### VALDETE DAKA EMËROHET EDHE PËR NJË MANDAT NË KRYE TË KQZ-së

F. 6

#### LORIK RAMAJ, 'USHTARI I VITIT 2018'

F. 3

### EKONOMI

#### QEVERIA MIRATON RAPORTIN TREMJOR TË BUXHETIT PËR VITIN 2018

F. 8

#### FAJDETË PO 'RREZIKOJNË' BIZNESET DHE QYTETARËT

F. 8

### KULTURË

#### 'KURBANI' PËRKTHEHET NË ITALISHT

F. 13



### SPORT

#### PRISHTINA NUK DËSHIRON TË LEJOJË BEFASI NDAJ LLAPIT

F. 16

#### AKILI MBETET PA MEDALJE, SOT GARON LORIANA KUKA

F. 16



SHASIVAR MAKOLLI

## Çali përkujtohet dhe nderohet për veprimtarinë atdhetare



Simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, dhe dhjetëra bashkëpunëtorë kanë përkujtuar të premten veprimtarin e çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Çali, me rastin e dyvjetorit të vdekjes së tij. Teksa kanë bërë homazhe te varri i "Çali"-t, duke vendosur nga një trëndafil të kuq, bashkëpunëtorët e tij kanë vlerësuar lart veprën e Shasivar Makollit. Sipas tyre, veprimtari Makolli një jetë ia kushtoi çështjes kombëtare

FAQE 3

## Thaçi: Çështja e të pagjeturve duhet të diskutohet në Bruksel

Presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar që çështja e të pagjeturve të diskutohet në nivelet më të larta të dialogut në Bruksel. Ai ka thënë se kjo temë nuk mund të presë më. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli është zotuar se do të bëjnë çdo gjë që

të ndriçohet fati i të pagjeturve. Po ashtu, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjnë të pamundurën që të zbardhet njëherë e përgjithmonë fati i të pagjeturve

FAQE 7



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Curtëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**SatStyro**  
Mushnikovë-Prizren-Kosovë  
Product of EPS and XPS  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: [sat.styro@yukon.com](mailto:sat.styro@yukon.com)  
www.satstyro.com  
Mob.: +377(0) 44 506 815

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijibiznesi.com  
info@kolegijibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

# Thaçi: Anëtarësimi në BE siguron paqe afatgjatë në rajon

Presidenti Hashim Thaçi ka thënë në Shkup se aspiratë e përbashkët është anëtarësimi i vendeve tona në Bashkimin Evropian dhe se ky anëtarësim do të thotë përcaktim për paqe të qëndrueshme, për stabilitet, për zhvillim, për prosperitet për të gjithë qytetarët tanë

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, mori pjesë të premtën në takimin e liderëve rajonalë, i cili u mbajt në Shkup, në kuadër të procesit të "Bërdo-Brione".

Në fjalën e tij presidenti Thaçi ka thënë se ky Samit dërgon mesazh të gjithë se rajoni ynë ka ndryshuar dhe se është shembull i zhvillimeve pozitive, duke përmendur organizimin e shumë takimeve rajonale në këta muajt e fundit. "Të gjitha këto takime kanë bërë të qartë për të gjithë që sot, vendet e Ballkanit, komunikojnë, bisedojnë, dialogojnë, me njëra-tjetrin si mjet për t'i zgjidhur çështjet e hapura që kemi, por edhe si mjet për t'i artikuluar qartë aspiratat tona për të ardhmen tonë", ka theksuar ai.

Thaçi ka thënë se "Bërdo-Brione" ka shërbyer si një inkubator nga i cili kanë dalë shumë ide e nisma, pastaj kanë marrë formë të bashkëpunimit rajonal e më gjerë. "Mbi të gjitha, këtu është konfirmuar nga të gjithë se aspiratë jona e përbashkët është anëtarësimi i vendeve tona në Bashkimin Evropian. Ky anëtarësim do të thotë përcaktim për paqe të qëndrueshme, për stabilitet, për zhvillim, për prosperitet për të gjithë qytetarët tonë", ka shtuar presidenti Thaçi. Sipas tij, të gjithë e kanë mirëpritur Strategjinë e Komisionit Evropian, e cila, 15 vjet pas Samitit të Selanikut, përsëri rikonfirmon qartë se të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor e kanë derën e hapur për t'u anëtarësuar në BE. "Samiti i Sofjes, i BE-së dhe Ballkanit Perëndimor ka karakter historik dhe është një mundësi e jashtëzakonshme për të gjithë ne", ka theksuar ai.

Presidenti Thaçi ka shtuar se

nga ky samit duhet ta nxjerrim maksimumin e mundshëm, si në çështjet që ndërlidhen me përmirësimin e infrastrukturës, energjisë, ndërlidhshmërisë, digjitalizimit, bashkëpunimit të të rinjve, në arsim etj. "Mbi të gjitha, duhet t'ua bëjmë të qartë shteteve anëtare të BE-së se ne si shtete kandidatë dhe aspirantë për anëtarësim në BE jemi të gatshëm për anëtarësim në Bashkimin Evropian", ka theksuar presidenti Thaçi, duke shtuar se tani duhet shfrytëzuar me kujdes dhe pa humbur kohë këtë momentum pozitiv të krijuar. Sipas tij, nëse ne dhe BE-ja vonohemi, atëherë të tjerë të cilët nuk kanë agjenda pozitive për rajonin do ta shtojnë ndikimin në rajonin tonë.

Presidenti Thaçi ka theksuar se në Kosovë jemi të përkushtuar t'i kryejmë detyrat tona. Kreu i shtetit ka thënë se Kosova mbetet e përkushtuar në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe në kërkim të një marrëveshjeje përfundimtare, ligjërisht të obligueshme për të dyja palët. Presidenti Thaçi ka ripërsëritur se nuk ka alternativë tjetër përveç dialogut. "Ne jemi të gatshëm ta mbyllim kapitullin e mosmarrëveshjeve, armiqësive, konfliktit dhe të hapim kapitullin e bashkëpunimit, fqinjësisë së mirë dhe pajtimit", ka shtuar i pari i vendit.

Duke folur për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, presidenti Thaçi ka thënë se javë më parë institucionet e Republikës së Kosovës kanë funksionalizuar Ekipin Menaxhues, i cili është kompetent për draftimin e statutit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. "Hartimi i statutit pritet të përfundojë brenda katër muajve, siç është paraparë me



Marrëveshjen e Brukselit. Kosovës të të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel. Ne të inkurajojë edhe Serbinë që t'i zbatojë në praktikë të gjitha marrëveshjet", ka thënë Thaçi.

## Meta takon Tuskun: Inkurajim për thellimin e reformave

**SHKUP, 27 PRILL** - Gjatë qëndrimit në Shkup, presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, zhvilloi një takim të veçantë me presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk. Presidenti Meta e konsideroi shumë të rëndësishme pjesëmarrjen e presidentit Tusk në Samitin e liderëve të procesit të Brdo-Brione, shenjë e vëmendjes dhe mbështetjes gjithnjë e më rritje të BE-së ndaj Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu, Meta vlerësoi vizitën dhe mesazhet inkurajuese që presidenti Tusk përcolli gjatë vizitës së tij në Tiranë, të cilat duhet të nxitin të gjitha institucionet shqiptare drejt arritjeve konkrete në zbatim të pesë prioritetëve kyçe.



Duke shprehur në vendimarrjen pozitive të Këshillit të qershorit ndaj rekomandimit për çeljen e negociatave të anëtarësimit të Shqipërisë, Meta theksoi se ky do të ishte një moment oportun për të marrë përgjegjësi të reja dhe më angazhuese karshi qytetarëve shqiptarë dhe partnerëve evropianë. Meta pohoi se Shqipëria i ka të gjitha mundësitë dhe angazhimin e shprehur qartë për të kaluar në fazën e vështirë të negociimit drejt anëtarësimit. Meta theksoi rëndësinë që ka edhe vendimi për liberalizimin e sa më të shpejtë të vizave me Kosovën, një hap i merituar që do ta mundësojë lëvizjen e lirë të qytetarëve kosovarë drejt hapësirës Shengen.

## Bushati takon Sekretarin amerikan të Shtetit

Bruksel, 27 prill - Ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme të Shqipërisë, Ditmir Bushati, ka takuar sekretarin amerikan të Shtetit të sapozgjedhur Mike

Pompeo në takimin e ministrave të jashtëm të NATO-s në Bruksel. Në një foto të shpërndarë në rrjetin social "Instagram", ministri Bushati thekson se i ka uruar suk-

sese në detyrën e re. "Një bisedë interesante me Mike Pompeo në ministerialin e jashtëm të NATO-s. I urova fat dhe suksese në detyrën e tij të re", u shpreh ministri Bushati.

Mike Pompeo është sekretari i ri i shtetit i konfirmuar nga Senati amerikan vetëm dy ditë më parë dhe menjëherë ka udhëtuar drejt Brukselit.



Të premten u bënë dy vjet nga vdekja e veprimtarit të çështjes kombëtare,  
Shasivar Makolli-Çali

## Çali përkujtohet dhe nderohet për veprimtarinë atdhetare

Simboli i rezistencës kombëtare Adem Demaçi dhe dhjetëra bashkëpunëtorë kanë përkujtuar të premten veprimtarin e çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Çali, me rastin e dyvjetorit të vdekjes së tij. Teksa kanë bërë homazhe te varri i "Çali"-t, duke vendosur nga një trëndafil të kuq, bashkëpunëtorët e tij kanë vlerësuar lart veprën e Shasivar Makollit. Sipas tyre, veprimtari Makolli një jetë ia kushtoi çështjes kombëtare



që nga ajo kohë unë kam pasur si shtëpinë time, shtëpinë e Shasivar Makollit. Në momentet më të rënda të jetës sime, shtëpia e Shasivar Makollit ka qenë bazë ku unë jam strehuar. Po ashtu, ajo shtëpi ka qenë bazë e shumë veprimtarëve të tjerë. Ka qenë shtëpi që ka shërbyer për ruajtjen dhe shpërndarjen e materialit, me të cilin më vonë u organizua lufta çlirimtare e Kosovës. Gjatë periudhës vendimtare, ku ndahej shapi nga sheqeri, Shasivar Makolli i qëndroi krah i djathtë simbolit të rezistencës, Adem Demaçit, duke mos iu ndarë asnjë ditë, derisa baca Adem e dërgoi në Zonën Operative të Llapit", ka thënë Mahmuti, duke shtuar se "Çali" Kosovës i dha shumë e nuk i mori asgjë. "Sot kemi ardhur ta përkujtojmë dhe do të mbetet në kujtesën tonë si një njeri i cili i dha Kosovës shumë, si një njeri që çështjes kombëtare i dha shumë dhe kurrë nuk mori asgjë. Lavdi e përjetshme jetës dhe veprës së Shasivar Makollit!", ka thënë ai.

Kurse bashkëveprimtari tjetër i Makollit, Fatmir Arifi, ka thënë se "Çali" ka lidhur tri gjenerata në një kauzë të vetme. "Të flasësh për Shasivar Makollin-'Çalin' nuk është bash e lehtë, sepse është njeri që lidhi tri gjenerata me një kauzë të vetme. Shasivar Makolli ishte shok edhe me gjeneratën time, që isha shumë më i ri se ai. Ai ishte shok edhe me gjeneratën e mesme, sikurse ishte shok edhe me gjeneratën e tretë. Ai arriti misionin e vet që këto tri gjenera-

ta t'i bëjë bashkë në një kauzë të vetme. Shasivar Makolli ishte ai që na ofroi drejt kolosit të madh, drejt filozofisë së të madhit Adem Demaçi. "Çali", për mendimin tim, është njeriu më i madh në kuadër të kauzës sonë kombëtare, është njeriu më modest të cilin e kam njohur, është njeriu më i singërt që kam takuar dhe ka qenë mësuesi më i mirë që ka ditur të na orientojë dhe të na disiplinojë në shërbim të çështjes kombëtare", ka thënë Arifi.

Të pranishmit në emër të familjes i ka falënderuar Merita Makolli, vajza e "Çalit". "Shumë i dashur baca Adem dhe të respektuar shokë, miq dhe dashamirë të familjes sonë, jemi të gëzuar që ju kemi këtu sot dhe ju falënderoj në emër të familjes që po na qëndroni pranë gjithmonë. Ne jemi të privilegjuar që ju kemi. Ju paçim gjithmonë me shëndet!", ka thënë vajza e veprimtarit Makolli.

Me këtë rast, homazhe kanë bërë edhe deputeti i PDK-së, Elmi Reçica, kryetari i KMDLNj-së, Behxhet Shala dhe shumë veprimtarë të tjerë.

EPOKA  
ERE

Muhamet KOCI

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Në dyvjetorin e vdekjes është përkujtuar veprimtari i çështjes kombëtare, Shasivar Makolli-Çali. Simboli i rezistencës kombëtare, Adem Demaçi, dhe dhjetëra bashkëpunëtorë të veprimtarit Makolli kanë bërë homazhe të premten te varri i tij, duke vendosur nga një trëndafil të kuq. Me këtë rast, veprimtari Bardhyl Mahmuti ka thënë se Shasivar

Makolli-Çali tërë jetën ia ka kushtuar çështjes kombëtare. "Sot në dyvjetorin e vdekjes së Shasivar Makollit jemi tubuar që përmes trëndafilëve të kuq të bëjmë homazhe pranë varrit të një njeriu, i cili tërë jetën ia kushtoi kauzës tonë kombëtare", ka thënë Mahmuti. Ai ka bërë me dije se shtëpia e Shasivar Makollit ka qenë bazë e shumë veprimtarëve të çështjes kombëtare. "Ka më shumë se 30 vjet që jam takuar për herë të parë me Shasivar Makollin dhe



## Lorik Ramaj, "Ushtari i vitit 2018"

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Në Kazermën "Adem Jashari" të Komandës së Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës të premten solemnisht u shpallën rezultatet e garës ndërkombëtare dhe të garës së FSK-së

"Ushtari më i mirë i vitit 2018". Rezultatet më të mira të garës së FSK-së dhe çmimin e parë "Ushtari i vitit 2018" e fitoi tetar Lorik Ramaj, pjesëtar i Brigadës për Reagim të Shpejtë, ndërsa rezultatet më të mira

dhe çmimin e parë të garës ndërkombëtare e fitoi OR-6 Vladimir Haxhijaj, pjesëtar i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në ceremoni ishin të pranishëm edhe ministri i FSK-së,

Rrustem Berisha, zëvendësministri Agim Çeku, komandanti i FSK-së, gjeneralletjëntant Rrahman Rama, oficerë të lartë të FSK-së, të KFOR-it si dhe oficerë e atashe të shteteve partnere të FSK-së.



Flet për "Epokën e re", Shyqyri Haxha

# Telekomi nuk duhet të privatizo



## - Telekomi mund të shpëtojë nga falimentimi - Nëse i hyj garës për kryeshef të Telekomit nuk do të pranoj të bëhem vegël e askujt

Ish-kryeshefi i Postës dhe Telekomit të Kosovës, Shyqyri Haxha, në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ka folur për situatën e krijuar në këtë kompani. Ai ka thënë se Telekomi mund të shpëtojë nga falimentimi dhe për këtë nuk ka asnjë dyshim. Haxha ka theksuar se Telekomi nuk duhet të privatizohet pas gjithë këtij degradimi që i është bërë. "Kjo kompani duhet të ristrukturohet, të kthjellët, t'i ngrihet vlera, pastaj të shqyrtohen mundësitë e privatizimit", ka thënë ai. Haxha ka treguar se ka marrë shumë mesazhe që ai të rikthehet në krye të Telekomit. Thotë se hëpërhë nuk ka përgjigje të prerë nëse do të jetë kandidat për kryeshef të Telekomit. "Në rast se i hyj garës nuk do të pranoj të bëhem vegël e askujt", ka thënë Haxha, duke shtuar se dikujt është duke i penguar zhvillimi dhe rritja e PTK-së

**EPOKA E RE** **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 PRILL -

"Epoka e re": Z. Haxha, ju vazhdimisht, që kur e keni lënë Telekomin, keni qenë aktiv sa i përket kësaj kompanie, duke dhënë sugjerime se si duhet të ecet tutje. Madje keni paralajmëruar se kështu si po ecën, një ditë do të falimentoj

Telekomi. Si e shihni sot këtë kompani? A mund të shpëtojë nga falimentimi?

**Shyqyri Haxha:** Që në ditët e fundit të punës sime në PTK, më 13 dhjetor 2011, kur e kam mbajtur konferencën e fundit për media rreth përmbylljes së punës sime të kryeshefit, kam ngrehur shqetësimin që të kenë kujdes me këtë kompani sepse mund ta shkatërroj.

Kam thënë kështu sepse kam kaluar nëpër një periudhë pabesish të tepër të madhe për faktin se PTK-ja ishte minuar edhe atëherë. Pa dashur të hyj shumë në detaje, opinioni e di shumë mirë suksesin e arritur dhe 'luftën' dhe 'goditjet' nga grupet e interesit. Telekomi mund të shpëtojë nga falimentimi dhe për këtë nuk kam asnjë dyshim. Është një kom-

pani e cila me një vullnet dhe përkrahje pozitive lehtë mund të ristrukturohet dhe t'i ngrihet vlera pa asnjë dyshim.

"Epoka e re": Cilët ishin faktorët që e sollën Telekomin në këtë gjendje? Një ndër arsyt është thënë se është edhe numri i madh i punëtorëve?

**Shyqyri Haxha:** Numri i madh i punëtorëve ka qenë edhe në kohën e menaxhimit tim, por me një punë dhe angazhim të stafit kemi arritur bilanc pozitiv dhe i kemi dhënë Qeverisë dividendë mbi 400 milionë euro. Natyrisht se, nëse kanë ndodhur ende punësime gjatë kohës kur kompania ka pasur bilanc negativ, sigurisht se kjo nuk do t'i ndihmojë kompanisë. Ngarkesat me staf dhe shpenzimet enorme në kohën kur kompania ka pasur rënie, janë shqetësuese.

"Epoka e re": Sot Telekomi ka shumë borxhe. Ju në një postim tuajin, në llogarinë tuaj në "Facebook", keni thënë se

keni mundësi, përvojë, kapacitet dhe guxim ta kthjellni këtë kompani. A do t'i hyni garës për kryeshef?

**Shyqyri Haxha:** Duhet hetuar se si janë krijuar këto borxhe. Dikush duhet ta marrë barrën e përgjegjësisë nëse ka krijuar borxhe që dëmtojnë kompaninë. Gjatë kohës sime jo që nuk janë krijuar borxhe, por i kemi mbledhur borxhet që ishin krijuar me vite nga menxhmentet e kaluara. Çdo borxh i krijuar me kujdes duhet të rishqyrtohet dhe, pas një analize të drejtë dhe profesionale, duhet të gjenden zgjidhjet që nuk e dëmtojnë afarizmin e kompanisë.

Natyrisht, gjithmonë duke ruajtur edhe partneritetin me kompani profesionale që bashkëpunojnë me Telekomin në një ambient të shëndoshë biznesor. Mund t'ju them se kam marrë përkrahje nga njerëz që ia dinë vlerën shtetit të Kosovës që t'i hyj garës për kryeshef ekzekutiv të Telekomit të Kosovës. Dua t'i falënderoj përzemërsisht për

# het pas gjithë këtij degradimi

post nëse aplikoj. Ajo që unë them tani është se nuk do t'i shërbej kurrë një individ apo grupi politik në kurriz të tjerëve dhe në kurriz të Telekomit. Në rast se i hyj garës nuk do të pranoj të bëhem vegël e askujt. Nëse faktori politik e ka përnjëmend që ta zhvillojë Kosovën, sot e ka rastin të fillojë nga këto dështime që kanë mbërthyer të gjitha ndërmarrjet publike. Trendi i degradimit është duke vazhduar vetëm në Kosovë dhe askund tjetër. Këto dështime kanë vënë në pikëpyetje edhe qëndrueshmërinë ekonomike të Kosovës si shtet. Kosova ka një fat të madh se ka një diasporë që e furnizon me para 'cash', pa asnjë shpenzim nacional. Bile diaspora edhe 'gjobitet' dhe i krijohen barrierat vetëm që ta vizitojë vendin e origjinës, Kosovën. Faktori politik nuk është duke ia ditur vlerën diasporës si nga aspekti i ndihmës financiare edhe nga aspekti i ngritjes dhe profesionalizimit intelektual. Sot diaspora është ari që ka filluar të zhgënjehet, pra dalëngadalë është duke humbur interesin që të investojë në Kosovë. Bile edhe për pushime verore apo dimërore kanë filluar të shkojnë në vende të tjera si rezultat i depresionit politik dhe atij ekonomik që kjo klasë politike ka krijuar qëllimisht apo nga padituria.

**"Epoka e re": Ju po thoni se angazhimi juaj për Kosovën nuk ka munguar. Po pse ky hezitim për t'i hyrë garës për kryeshef të PTK-së? Nuk e keni përkrahjen e politikës apo jeni zhgënjyer nga koha kur keni shërbyer kryeshef, sepse edhe në atë kohë, në fund të mandatit, keni pasur kritika?**

**Shyqyri Haxha:** Kritikat kanë

qenë nga grupet e interesit, kritika të orkestruara dhe me paramendim që të ma pamundësojnë vazhdimin e suksesit në PTK. Pikërisht ato burime të kritikave janë ata që sot janë pjesë e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e falimentimit të Telekomit. Nëse e bëni një analizë, shikoni sa pak apo thuajse fare nuk është shkruar për shkatërrimin e Telekomit. Si u bë që për një moment tash po falimenton Telekomit dhe asnjë media nuk e përcolli shkatërrimin gradual që iu bë kësaj korporate për 10 vjet me radhë. Ju po thoni kritika, por nuk kanë qenë kritika. Kanë qenë 'klithje' që t'u lëshohet rruga për ta kullotur Telekomin dhe ia arritën. Sot profiterët më të mëdhenj janë pikërisht ata kritikuesit dhe ata që u morën me mua për tre vjet në baza ditore. Sa i përket përkrahjes politike, unë nuk kam qenë anëtar i asnjë partie politike. Kurrë në jetën time nuk kam marrë asnjë librezë të ndonjë partie politike. Kritikat më të mëdha dhe betejën më të madhe e kam pasur në atë kohë pikërisht me partitë në pushtet, pra kritikant kanë qenë rreth politikave zhvillimore dhe strategjisë së gabuar që është aplikuar nga ministrat e linjës në atë kohë. Në asnjë moment nuk kam pranuar nga Qeveria të aplikojë politika degraduese për PTK-në, prandaj këtu edhe na u thyen shpatat. Kemi pasur konfrontime të jashtëzakonshme nëpër takime ndërministrare me ministrat e linjës rreth vendimeve të tyre degraduese për PTK-në. Kjo nuk më ka ndihmuar mua personalisht aspak, por i ka ndihmuar PTK-së, sepse kjo kompani është mbrojtur. Prandaj edhe filloi

fushata kundër meje, sepse ministra joprofesionale dhe me një hamendje shkel e shko merrin vendime joprofesionale dhe bënë ndërhyrje kundërligjore që e dëmtuan PTK-në.

**"Epoka e re": Edhe në postimin tuaj të fundit në "Facebook" flisni për profiterë politikë, për të cilët thoni se jeni të gatshëm të ballafaqoheni me ta. Kujt i ka penguar dhe po vazhdon t'i pengojë rritja dhe zhvillimi i PTK-së/Telekomit?**

**Shyqyri Haxha:** Zhvillimi dhe rritja e PTK-së u ka penguar atyre që kanë pasur për qëllim ta devalvojnë, t'ia ulin vlerën dhe përfundimisht ta privatizojnë bashkë me grupe të interesit vendorë dhe ndërkombëtarë. Mos harroni, ka pasur dhe besoj se ende ka qarqe ndërkombëtare dhe vendore që presin ta shohin PTK-në edhe më të lodhur, në mënyrë që ta gjunjëzjnë ende dhe ta grabisin në emër të privatizimit.

**"Epoka e re": A mund të jetë e gjithë kjo situatë si mundësi që Telekomit të privatizohet?**

**Shyqyri Haxha:** Tash imagjinojeni se çfarë sot ka Telekomit në krahasim me vitet 2011. Goditjet për devalvim të vlerës së PTK-së kanë ardhur nga ndërhyrjet përmes EULEX-it. Ato ndërhyrje kanë qenë pikërisht të orkestruara nga politika që të devalvohet vlera e PTK-së pikërisht në fazën e privatizimit. Telekomit i Kosovës nuk mund të privatizohet pas gjithë këtij degradimi. Kjo kompani duhet të ristrukturohet, të kthjellat, t'i ngrihet vlera, pastaj të shqyrtohen mundësitë e privatizimit.

përkrahjen dhe ftesën e tyre shumë të sinqertë. Ndihej i privilegjuar kur shoh kaq shumë përkrahje për mua. Pyetjes suaj, se a do t'i hyj garës për drejtor, është vështirë t'i përgjigjem.

**"Epoka e re": Pse?**

**Shyqyri Haxha:** Puna ime dallon nga shumë kandidatë të tjerë potencialë për këtë post. Unë nuk jam pa punë dhe nuk kam nevojë ta lus askënd të më përkrah padrejtësisht për këtë

## Avokati i Popullit: Institucionet shkelën Kushtetutën me deportimin e gjashtë shtetasve turq

PRISHTINË, 27 PRILL - Avokati i Popullit ka dalë të premtën me raport sipas detyrës zyrtare, me rekomandime për institucionet e Kosovës "largimin me forcë" apo ekstradimin nga territori i Republikës së Kosovës të gjashtë shtetasve turq. Pas grumbullimit të informatave dhe analizës së rastit, Avokati i Popullit ka konstatuar se në rastin në fjalë autoritetet e Republikës së Kosovës, duke i dëbuar shtetasit turq, ata i ekspozuan në rrezik real për t'iu nënshtruar torturës, keqtrajtim-it fizik dhe rrezikut real për

shkelje serioze të të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të cilat janë pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës. "Avokati i Popullit është i mendimit se autoritetet e Republikës së Kosovës, të cilat dëbuan të huajt në fjalë, nuk kanë bërë një vlerësim se cilat janë garantitë kundër keqtrajtim-it fizik dhe torturës në shtetin e tyre të origjinës dhe pa e marrë parasysh situatën e të drejtave

të njeriut në atë vend", thuhet në njoftimin për media të dërguar nga zyra e Avokatit të Popullit.

Sipas Avokatit të Popullit, me rastin e deportimit të shtetasve turq janë shkelur neni 29, paragrafët 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës që flasin për të drejtën e lirisë dhe sigurisë; neni 31 apo të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; neni 32 për të drejtën për mjete juridike; neni 14, paragrafi 1, neni 15, neni 16, paragrafët 1 dhe 2, neni 17, paragrafët 2 dhe 6.



Përkujtohet masakra e Mejës së Gjakovës në 19-vjetorin e saj

# Meja, çmimi që Kosova e pagoi për liri

Kompleksi Memorial në Mejë i tregon botës për të vërtetën, sakrificën dhe çmimin që është dashur ta paguajë Kosova për liri. Kështu është thënë të premten në tubimin qendror me rastin e 19-vjetorit të masakrës në Mejë të Gjakovës ku janë përkujtuar 376 martirët. Me këtë rast, kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj, ka thënë se në Mejë na ruajnë varret dhe gjaku i martirëve

**EPOKA E RE** **Qendresa RAMA**

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë të premten se në Mejë të Gjakovës na ruajnë varret dhe gjaku i martirëve, të cilët janë nderi ynë. Ai ka thënë se Kompleksi Memorial në Mejë është nderi i shqiptarëve që i tregon botës sakrificën dhe çmimin për lirinë e Kosovës.

"Duke kujtuar dhe shprehur ndjenjën e posaçme për Mejën, do të kujdesemi që ky kompleks, që është nderi i shqiptarëve, të na nderojë edhe në mënyrën se si do t'i tregohet vetes dhe botës për të vërtetën tonë, sakrificën dhe çmimin tonë për liri. Kosova e ka fatin e madh dhe ky vend dëshmon që ne dëshirojmë t'u takojmë popujve të lirë. Dhimbja për të rënë mund të kthehet në dritë", është



shprehur Haradinaj në manifestimin qendror me rastin e 19-vjetorit të masakrës së Mejës.

Para të pranishmëve Haradinaj ka thënë se populli i Kosovës është rreshtuar për t'i takuar botës se mençur dhe popujve euroatlantikë. Sipas tij, popujt e lirë kanë ditur të vendosin demokraci të mirëfilltë dhe respektuar të drejtat e njeriut. "Ne jemi në nisje dhe nisjet janë të rënda, por ne nuk lëkundemi në përcaktimin tonë euroatlantik", ka deklaruar kryeministri Haradinaj, duke shtuar se Evropa s'ka pse të vonohet për të na pranuar edhe ne në familje, sepse Kosova është bërë shtet vonë, por ekziston mijëra vjet më parë.

Kryeministri Haradinaj ka pohuar se Kosova duhet të njihet nga vendet që ende s'e kanë njohur dhe nga fqinjët e saj, të anëtarësohet në BE, në NATO dhe në OKB. Me këtë rast kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka bërë homazhe në nderim të 376 viktimave në Kompleksin Memorial në Mejë, i shoqëruar nga kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini dhe përfaqësues të tjerë institucionalë. Ndërkaq kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, duke kujtuar martirët, është zotuar se do të bëjë të pamundurën që në 20-vjetorin e masakrës së Mejës, masakrës më të madhe në Kosovë, ky memorial të jetë i përfunduar.

## Ministrja Hoxha emërohet koordinatore kombëtare për IPA

**PRISHTINË, 27 PRILL (ER)**

- Kabineti qeveritar ka emëruar të premten ministren e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, koordinatore kombëtare për Instrumentin Para-Anëtarësimit (IPA) dhe për donacione të tjera që vijnë në Kosovë. Me këtë vendim është fuqizuar përkushtimi



ndaj strukturimit të fondeve të ardhura nga vendet e tjera si asistencë për Kosovën. ?? Ministrja e Integritimit, në cilësinë e koordinatores nacionale, do të angazhohet për koordinimin e prioritetëve dhe politikave të Qeverisë dhe donacioneve të marra si asistencë për Kosovën. "Është përkushtim i

ministres Hoxha që si koordinatore nacionale të ndihmojë në sinkronizimin e asistencës së donatorëve dhe prioritetëve të Qeverisë, në mënyrë që përfuturit kryesorë të jenë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe mirëqenia e tyre", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Integritimit Evropian.



## Valdete Daka emërohet edhe për një mandat në krye të KQZ-së

**PRISHTINË, 27 PRILL (ER)** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të premten ka emëruar Valdete Dakën edhe për një mandat në krye të Komisionit Qendror të

Zgjedhjeve (KQZ). "Deklaroj solemnisht se do t'i kryej detyrat e mia si kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në mënyrë të ndershme, besnike, të paanshme, profesionale dhe të

ndërgjegjshme", ka thënë kryetaria Daka gjatë betimit të saj. Presidenti Thaçi i ka uruar kryetares Daka suksese të reja në punën e kryetares së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

# Thaçi: Çështja e të pagjeturve duhet të diskutohet në Bruksel

Presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar që çështja e të pagjeturve të diskutohet në nivelet më të larta të dialogut në Bruksel. Ai ka thënë se kjo temë nuk mund të presë më. Edhe kryeparlamentari Kadri Veseli është zotuar se do të bëjnë çdo gjë që të ndriçohet fati i të pagjeturve. Po ashtu, zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjnë të pamundurën që të zbardhet njëherë e përgjithmonë fati i të pagjeturve

EPOKA  
ERE

Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka thënë të premten se çdo 27 prill na bashkon për të kujtuar gjithmonë çmimin e lartë të lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Ai ka thënë se familjet e personave të zhdukur meritojnë ta dinë të vërtetën. "Që disa ditë Kosova po shënon 'Javën e Personave të Pagjetur'. Nderojmë dhimbjen e familjeve të tyre, të familjarëve pranë të cilëve do të jemi gjithmonë. Edhe 19 vjet pas luftës, e dimë se çdo ditë shumë familje jetojnë me dhimbje shpirtërore. Humbja e më të dashurve për shumë familje është edhe më e madhe për faktin se ende nuk dihet ku gjenden trupat e tyre. Familjet e personave të zhdukur meritojnë të dinë të vërtetën", është shprehur Thaçi.

Ai ka thënë se institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjnë maksimumin që të ndriçohet ky aspekt i ndjeshëm etik dhe njerëzor. "Zbardhja e të kaluarës tragjike dhe dalja para drejtësisë e autorëve të krimit forcon ndërgjegjen njerëzore dhe rritë paqen në vend dhe rajon. Autorët e krimeve, masakrave, dëbimit, zhdukjes dhe formave të tjera të vrasjeve sistematike të qytetarëve tanë duhet të vihen para drejtësisë.

Autoritetet e Beogradit duhet të përgjigjen dhe të ofrojnë të dhëna edhe për 1 650 personat që vazhdojnë të jenë të evidentuar si të zhdukur gjatë luftës. Andaj, edhe sot, nga këtu, ne thërrasim ndërgjegjen e autoriteteve serbe dhe presim nga faktorët ndërkombëtarë të ushtrojnë trysni te këto autoritete për të ofruar të dhëna për qytetarët tanë të zhdukur gjatë luftës", ka thënë Thaçi.

Presidenti i vendit ka theksuar se çështja e personave të zhdukur duhet të shtrohet në nivelet më të larta, edhe në Bruksel, si një temë që nuk pret më. Thaçi ka shprehur falënderim për të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe ka vlerësuar lart punën e Komisionit Qeveritar për Persona të Pagjetur. "Falënderoj shoqatat e familjarëve të personave të pagjetur dhe ju garantoj se do ta kemi mbështetjen time maksimale. Nuk do të reshtin përpjekjet tona që kjo çështje, kjo plagë e rëndë e luftës, të mbyllet sa më parë, për të hapur mundësi të reja dhe për t'i gjetur paqen dhe pajtimin", ka deklaruar Thaçi.

Presidenti ka thënë se familjet e personave të pagjetur dhe të gjitha viktimave të luftës, pa dallime etnike, meritojnë respektin më të madh dhe të përjetshëm institucional. Edhe kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, është zotuar se do të bëjnë çdo gjë që të ndriçohet fati i të pagjeturve.



Ai ka thënë se ky është obligim ndaj të kaluarës dhe të ardhmes. "Pothuajse dy dekada pas përfundimit të luftës, plagët e saj ende rëndojnë. Janë mijëra qytetarë të Kosovës ende të pagjetur. Serbia po vazhdon të heshtë, por ne nuk harrojmë dhe nuk do të ndalemë së kërkuari drejtësi për qytetarët tanë. Do të bëjmë çdo gjë që të ndriçohet fati i tyre. E kemi obligim ndaj të kaluarës dhe të ardhmes sonë", ka deklaruar Veseli.

Edhe zëvendëskryeministri Fatmir Limaj ka thënë se insti-

tucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet të bëjnë të pamundurën që të zbardhet njëherë e përgjithmonë fati i të pagjeturve. Ai ka thënë se Serbia duhet të kuptojë se nuk mund t'i mbajë peng familjet e të pagjeturve dhe se autoritetet e Beogradit duhet ta pranojnë zbardhjen e fatit të tyre. "Me rastin e Ditës së të Pagjeturve të Kosovës, qëndrojmë afër familjeve të cilat ende nuk dinë gjë për më të dashurit e tyre. Kjo plagë, e cila vazhdon të rëndojë mbi shtetin e Kosovës, duhet të

mbyllet njëherë e përgjithmonë. Institucionet e Kosovës dhe bashkësia ndërkombëtare duhet ta bëjnë maksimumin dhe të pamundurën që të zbardhet njëherë e përgjithmonë fati i qytetarëve tanë të pagjetur. Serbia duhet të kuptojë se nuk mund t'i mbajë peng familjet e të pagjeturve dhe se autoritetet e Beogradit duhet ta pranojnë zbardhjen e fatit të të pagjeturve. Kryerësit e këtyre krimeve duhet ta marrin përgjigjen e duhur nga institucionet e drejtësisë", ka thënë Limaj.

# Thaçi takon Xhaferin, flasin për të drejtat e shqiptarëve në Maqedoni



**SHKUP, 27 PRILL (BR)** - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, të premten është takuar me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, me të cilin ka biseduar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Thaçi ka përgëzuar Xhaferin për punën dhe reformat që

është duke i bërë koalicioni i ri qeverisës, në përmbushjen dhe përshpejtimin e agjendës euroatlantike të Maqedonisë. "Vizitën time zyrtare në Shkup, për të marrë pjesë për në Samitin e 'Brdo Brijuni', e filllova paraprakisht me kryetarin e Kuvendit të Maqedonisë, Talat Xhaferi. Biseduam për marrëdhëniet tona ndërmjet dy shteteve

dhe avancimin e të drejtave të shqiptarëve në Maqedoni. Kryetarin Xhaferi e përgëzova për punën dhe reformat që është duke i bërë koalicioni i ri qeverisës, në përmbushjen dhe përshpejtimin e agjendës euroatlantike të Maqedonisë. Kosova i gëzohet çdo suksesi të Maqedonisë fqinjë", ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

# Ministri Lluka: TIK-u, faktor ndërlidhës i sektorëve ekonomikë

**EPOKA  
ERE****Arbisa SHEFKIU**

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka bërë me dije se Teknologjia e Informimit dhe Komunikimeve (TIK) është faktori kryesor që ndërlidh sektorë të ndryshëm ekonomikë duke mundësuar rritjen e efikasitetit dhe profilit të kompanive, rrjedhimisht zhvillimin ekonomik të vendit. Këto komente kreu i MZhe-së i bëri të premtën në hapje të konferencës me temën "Vajzat në TIK".

Ministri Lluka ka thënë me këtë rast se MZhe-ja vazhdimisht e

përkrah këtë program, pasi ky institucion mbulon sektorin e TIK-ut dhe kryesisht merret me investimet në infrastrukturë dhe ndërtimin e shkathhtësive në këtë fushë. "Është kënaqësi që Kosova është pjesë e këtij promovimi. MZhe-ja tashmë ka disa projekte siç janë: WOW, një program i cili ka trajnuar mbi 400 vajza, ku gjysma prej tyre kanë punësuar. Projekti që është në ardhje e sipër është projekti i quajtur 'Ekonomia digjitale' që mundëson lidhjen e të gjithë sektorëve ekonomikë përmes TIK-ut", ka deklaruar ai. Duke folur për projektin 'Ekonomia digjitale', ministri Lluka ka pohuar se qëllimi kryesor

i këtij projekti është përmirësimi i infrastrukturës, ku mbi 20 milionë euro do të hyjnë në infrastrukturë, derisa një pjesë tjetër e fondit do të shkojë për krijimin e vendeve të reja të punës. Sipas tij, me finalizimin e këtij projekti brenda dy vjetëve Kosova do të ketë një pozitë shumë më të mirë në këtë aspekt.

Një angazhim tjetër me rëndësi në këtë drejtim, ministri Lluka ka përmendur edhe projektin e TechPark, objektin e të cilit Qeveria do t'ia japë në shfrytëzim për 20 vjet STIKK-ut, ku bizneset mund t'i zhvillojnë idetë e tyre inovative dhe t'i zhvillojnë shërbimet e tyre në sektorin e TIK-ut.

Drejtoresha e programit në IPKO Foundation, Abetare Gojani, duke folur për aktivitetin "Vajzat në TIK", ka pohuar se ky është viti i katërt që organizohet, duke e vlerësuar mjaft të suksesshëm. "Gjatë tre vjetëve të fundit kemi pasur diku 900 pjesëmarrëse të trajnuara, më shumë se 60 kompani pjesëmarrëse në panairin e punës si dhe mbi 100 pjesëmarrës të regjistruar në panairin e punës. 42 për qind e vajzave nëpërmjet këtij panairi të punës kanë arritur të punësohen, do të thotë të fitojnë kontrata të rregullta të punës", ka deklaruar ajo.

Ndërkaq shefi i operacioneve dhe zyrtar për marrëdhënie me jashtë

në RIT - Kosova (AUK), Visar Jasiqi, ka deklaruar se nga disa statistika në vitin 2013 u tha se vetëm 20 për qind të punësuarve në sektorin e IT-së i takojnë gjinisë femërore prandaj, sipas tij, RIT Kosova ka marrë një iniciativë, së cilës iu bashkuan edhe shumë partnerë të tjerë, në mënyrë që të ndryshojë perceptimi për këtë sektor.

Dita Ndërkombëtare e Vajzave në TIK festohet në më shumë se 150 shtete përmes ngjarjesh të ndryshme që synim kanë një mjedis lokal i cili fuqizon dhe nxit vajzat dhe gratë që të mendojnë për karrierë në sferën e informacionit dhe komunikimit.

## Fajdetë po 'rrezikojnë' bizneset dhe qytetarët

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Kushtet e pafavorshme afariste, normat e larta për kredi dhe procedurat e zgjata për realizimin e kredive, në bankat komerciale që operojnë në Kosovë, kanë bërë që bizneset, por edhe persona të ndryshëm, në disa raste të përdorin burime alternative duke huazuar para në mënyrë ilegale me normë të lartë të interesit. Paratë e huazuara në mënyrë ilegale, që njihen si "fajde", jo rrallëherë janë bërë shkas i nxitjes së konflikteve mes individëve të ndryshëm, por edhe shkas për mbylljen e bizneseve, thonë përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe ekspertë për çështje financiare.

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, vetëm gjatë vitit të kaluar janë iniciuar për hetim 25 raste si fajde të përcaktuara sipas Kodit



Penal të Republikës së Kosovës, kurse në tremujorin e parë të këtij viti janë iniciuar gjashtë raste për këtë çështje.

Agim Shahini nga Aleanca Kosovare e Biznesit konsideron se ky fenomen është më i shprehur por, sipas tij, personat e përf-

shirë në këtë fenomen kërcënohen në rast të lajmërimit të rasteve në organet e rendit. "Ky fenomen ka hyrë në disa shtesa

të shoqërisë saqë personat e përfshirë janë bërë të paprekshëm. Ne mendojmë se ky është fenomeni më i rëndë i shoqërisë së Kosovës dhe kjo ndikon tek ekonomia joformale, tek bizneset të cilët, në mungesë të mjeteve, në forma legale tentojnë të marrin para. Por, këto janë aq të shtrenjta saqë ka pasur raste që kanë ardhur deri tek vrasjet", ka thënë Shahini. Ai kërkon nga organet kompetente mos të rrinë pasivë karshi këtyre aktiviteteve joligjore.

Ish-guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Hashim Rexhepi, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se sektori bankar duhet të krijojë lehtësira për marrjen e kredive, konkretisht për biznese fillestare pasi, sipas tij, këto biznese kanë probleme për sigurimin e mjeteve financiare.



# Qeveria miraton raportin tremujor të buxhetit për vitin 2018

Kabineti qeveritar ka miratuar të premten raportin tremujor të buxhetit për vitin 2018.

Raporti përmban përmbledhjen e të hyrave dhe të shpenzimeve të tremujorit të parë të këtij viti si dhe analizën përmbledhëse të periudhës. Në këtë periudhë, sipas raportit, janë regjistruar të hyra gjithsejtë në vlerë 408,52 milionë euro, ndërsa shpenzimet janë 413,47 milionë euro

EPOKA  
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 PRILL - Qeveria e Kosovës ka miratuar të premten konceptdokumentin për Dhomën e Veçantë të Gjykatës Supreme. Dhoma e Posaçme funksionon në kuadër të Gjykatës Supreme dhe trajton ekskluzivisht çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Sipas kornizës aktuale ligjore, kjo gjykatë gjykon në kolegje të për-

bëra nga gjyqtarë vendorë dhe ndërkombëtarë, këta të fundit të emëruar nga EULEX-i. Për shkak të përbërjes së përzier të gjyqtarëve të sanksionuar me Ligjin e Dhomës së Posaçme, me përfundimin e mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë më 14 qershor 2018, puna në këtë gjykatë paralizohet në tërësi. Prandaj, një ndër arsyt kryesore për hartimin e këtij konceptdokumenti është shqyrtimi i opsioneve dhe rekomandimi i opsionit që garanton

vazhdimësinë e punës, njëkohësisht mundëson përmirësimin e gjendjes së rënduar në këtë gjykatë.

Me vendimin e miratuar të premten nga kabineti qeveritar, Avokatura Shtetërore është autorizuar t'u bartë lëndët e regjistruara dhe ta bëjë delegimin e kompetencave të përfaqësimit në kontestet pasurore-juridike, administrative dhe të arbitrazhit, tek autoritetet publike për të cilat Ministria e Drejtësisë ka të drejtën e autorizimit, por jo detyrimin e përfaqësimit në gjykata dhe organe të tjera.

Qëllimi i vendimit është funksionalizimi dhe zbutja e ngarkesës së Avokaturës Shtetërore dhe siguri i përfaqësimit adekuat dhe profesional të interesave të autoriteteve publike. Ky organ aktualisht përballet me një numër tejet të madh të lëndëve (19 630

lëndë) dhe ka një staf prej shtatë avokatësh.

Po në mbledhjen e kabinetit qeveritar është miratuar edhe koncept-dokumenti për trajtimin e kuadrit ligjor të tatimeve dhe procedurave të fushëveprimit të Administratës Tatimore të Kosovës. Në këtë mbledhje të Qeverisë është miratuar raporti tremujor i buxhetit 2018. Raporti përmban përmbledhjen e të hyrave dhe shpenzimeve të tremujorit të parë të këtij viti si dhe analizën përmbledhëse të periudhës. Në këtë periudhë, sipas raportit, janë regjistruar të hyra gjithsejtë në vlerë 408,52 milionë euro, ndërsa shpenzimet janë 413,47 milionë euro.

Raporti evidenton se trendi i të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore gjatë kësaj periudhe ka qenë brenda kufijve të planifikuar. Kabineti qeveritar ka aprovuar

edhe Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2019-2021. Korniza e aprovuar do të procedohet në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo Kornizë Afatmesme e Shpenzimeve reflekton prioritetet strategjike të Qeverisë. Rritja ekonomike në këtë periudhë parashihet të jetë 5 deri në 5.3 për qind, ndërsa të hyrat buxhetore do të shënojnë rritje për 18.9 për qind.

Shpenzimet në këtë kohë do të shënojnë rritje prej 19.3 për qind.

Me propozimin e kryeministrit Ramush Haradinaj, Qeveria e Kosovës ka ndarë mjete financiare në vlerë prej 40 mijë eurosh për mbështetjen e projekteve në dobi të komunitetit kroat në Kosovë. Po në këtë mbledhje, Qeveria ka emëruar Nehat Thaçin drejtor të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.



## Dukolli: Punëdhënësit të ofrojnë siguri maksimale në vendet e punës

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Zëvendësministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Çerkin Dukolli, ka marrë pjesë të premten në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Siguri dhe Shëndetin në Punë, organizuar nga kompania "Sharr Cem". Zëvendësministri Dukolli ka thënë se kujdesi institucional për siguri dhe shëndet në punë, përveçse është obligim ligjor, është çështje humane, ngaqë kemi të bëjmë me ruajtjen e shëndetit dhe jetës së njeriut. "Ofrimi i ambientit të sigurt dhe të shëndetshëm në vendet tona të punës, nënkupton ruajtjen e jetës dhe shëndetit të punëtorëve, punëdhënësve, edhe të gjithë atyre që për ndonjë arsye



apo tjetër kanë qasje në ambientet e punës", është shprehur ai. Dukolli ka theksuar se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka ndërmarrë veprime të kon-

siderueshme në këtë drejtim. "Rrjedhimisht kemi harmonizuar legjislacionin nga kjo fushë me atë të BE-së, kemi ndërtuar trupat ekzekutive inspektuese dhe

përtej saj çdo vit po ndërmarrim fushata vetëdijësuese, me qëllim që t'i informojmë palët për detyrimet që kanë në raport me aktet juridike të sigurisë dhe shëndetit në punë", ka deklaruar Dukolli.

Lidhur me masat konkrete për ruajtjen e shëndetit në punë, zëvendësministri Dukolli i ka njoftuar të pranishmit se Qeveria e Kosovës ka themeluar Këshillin Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, i cili në kompetenca të veta ka jo vetëm konstatimin e gjendjes, por edhe hartimin e politikave për përmirësimin e nivelit të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe përcjelljen në vazhdimësi të gjendjes së sigurisë dhe shëndetit në punë të të punë-

suarve.

Zëvendësministri Dukolli, i cili njëherësh është edhe kryetar i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, u ka bërë thirrje të gjithë punëdhënësve që të krijojnë ambiente të sigurta pune, punëtorët të kujdesen për sigurinë e tyre dhe të tjerëve, gjithsesi t'i përdorin pajisjet e duhura për siguri dhe mbrojtje në punët e tyre specifike. Po ashtu, ai ka e inkurajuar Inspektoratin e Punës ta vazhdojë punën në bazë të dispozitave ligjore, që përmes inspektimeve në terren ta mundësojnë zbatimin e plotë të legjislacionit në fuqi që rregullon të drejtat dhe detyrimet mbi marrëdhënien e punës, por edhe sigurinë dhe shëndetin në punë.

## Ferizaj dhe Theranda, të vendosura për t'i mbrojtur pyjet nga dëmtuesit

**FERIZAJ, 27 PRILL (ER)** - Me ftesë të kryetarit të Komunës së Therandës, Bali Muharremaj, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë në Komunën e Ferizajt, Burim Bajrami, ka marrë pjesë të premtën në takimin e organizuar rreth sfidave në fushën e pylltarisë, saktësisht mbrojtjen e pyjeve nga dëmtuesit dhe masat institucionale që ndërmarrin këto komuna në këtë drejtim. Në këtë takim

Bajrami ka prezantuar gjendjen e pyjeve në territorin e Ferizajt, masat që ka ndërmarrë dhe po ndërmerr vazhdimisht qeverisja lokale e udhëhequr nga kryetari Agim Aliu për t'i mbrojtur pyjet nga keqbërësit si dhe për shkëmbimin e përvojave institucionale mes dy komunave. Komuna e Ferizajt dhe ajo e Therandës janë të vendosura për luftimin e dëmtuesve të pyjeve.



## Gjini nderon dëshmorët dhe martirët e Skivjanit

**GJAKOVË, 27 PRILL (ER)** - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka bërë homazhe të premtën dhe ka vendosur kurora me lule te lapidari i dëshmorëve dhe

martirëve të Skivjanit. Me këtë rast, Gjini ka thënë se duhet të punojnë së bashku për një Kosovë më të mirë për të gjithë. "Duhet të jeni krenarë për më të dashurit tuaj, për

sakrificën dhe gjakun e tyre të dhënë për Kosovën e lirë dhe të pavarur. Duhet të jemi bashkë dhe të punojmë për qëllimet e një Kosove më të mirë", ka thënë Gjini.



## Pastrohet ambienti përreth liqenit në Mirushë

**MALISHEVË, 27 PRILL (ER)** - Në kuadër të punës së përditshme të njësies së "Ekoregjionit" në Malishevë është organizuar të premtën një aksion i madh për pastrimin e ambientit përreth liqenit "Mirusha". Këtij aksioni i janë përgjigjur edhe zyrtarët komunalë, të prirë nga kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj. Në këtë aksion kanë marrë pjesë mbi 60 punëtorë të njësies së "Ekoregjionit" në Malishevë, bashkë me zyrtarë

komunalë. Me këtë rast, kryetari Begaj ka thënë se sfida për Komunën e Malishevës mbetet ruajtja e ambientit. "Pastrimi i ambientit ka qenë edhe është synimi im kryesor, prandaj së bashku me njësinë e 'Ekoregjionit' dhe në bashkëpunim me kryetarët e fshatrave do të vazhdojmë të angazhohemi që jo vetëm ta pastrojmë ambientin, por edhe ta ruajmë. U bëj thirrje të gjithë banorëve të komunës së Malishevës që ta ruajnë

ambientin", ka thënë Begaj. Ndërsa përgjegjësi i njësies së "Ekoregjionit" në Malishevë, Sejdi Paçarizi, ka bërë të me dije se aksione të këtilla do të vazhdojnë edhe në ditët e ardhshme në mënyrë që përfundimisht të largohen mbeturinat. Liqeni në Mirushë është një prej vendeve më të vizituara në komunën e Malishevës, pas ujëvarave dhe pishinave, por ambienti përreth liqenit është ndotur në masë të madhe gjatë vërshimeve të fundit.

## Asamblistët e fëmijëve nga Prizreni vizituan Komunën e Mitrovicës

**Mitrovicë, 27 prill (ER)** - Në sallën e Kuvendit të Komunës së Mitrovicës është realizuar mbledhja e radhës në mes të asamblistëve të fëmijëve nga qyteti i Prizrenit dhe qytetit të Mitrovicës.

Asambleja Komonale e Fëmijëve është organ legjitim i përfaqësimit të fëmijëve në vendimmarrje në nivel lokal dhe ambient ku vazhdimisht promovohen liritë dhe të drejtat e fëmijëve. Qëllimi i këtij takimi kishte të bëjë kryesisht me shkëmbimin e përvojave të tyre, me ç'rast u njoftuan nga afër me sfidat të cilat po përballen të dy asambletë, njëkohësisht u diskutua për realizimin e projekteve të përbashkëta për vitin e ardhshëm. Fillimisht hapjen e



diskutimit e bëri koordinatori i Njësies për të Drejtat e Njeriut nga Komuna e Mitrovicës, Fitim Rama, i cili i ka përgëzuar asamblistët e rinj nga të dy qytetet për këtë iniciativë që, sipas tij, do të shërbejë si urë lidhëse në shkëmbim të përvojave. Ndërsa në fjalën e tij kryetari i Asamblesë së Fëmijëve në Komunën e Mitrovicës, Irfan Peci, u zotua se vazhdimisht do të punohet për promovimin e lirive dhe të drejtave të fëmijëve.

## Figura e Idriz Seferit do të gdhendet në shkëmb

**KAÇANIK, 27 PRILL (ER)** - Kuvendi Komunal i Kaçanikut ka mbështetur iniciativën për gdhendjen në shkëmb të figurës së heroit kombëtar, Idriz Seferi.

Gdhendja e figurës së heroit Seferi do të bëhet tek Gryka e Kaçanikut.

Para asamblistëve të Kaçanikut, në emër të Fondacionit "Idriz Seferi" për jetësimin e këtij projekti ka folur profesori universitar Sabri Kadriu. Pas sqarimeve të nevojshme, asamblistët e të gjitha partive e kanë mbështetur unanimisht këtë iniciativë.



# PO, KOSOVA ËSHTË DJEP I KRIMEVE SERBE!



Shkruan: Jakup KRANSIQA

Mediet tona, siç ndodhi më 26 prill 2018, si zakonisht, nuk hezitojnë të na shërbejnë çdo dërdëllisje të zyrtarëve të lartë serbë të thënë për Kosovën e shqiptarët. Të atyre zyrtarëve të sotshëm, që dje ishin zyrtarë të zellshëm të politikave të krimit e të gjenocidit serb pikërisht në Kosovë. Në fakt, të gjitha politikat serbe ndaj shqiptarëve, që nga Garashanini (1844) e deri më sot, kanë qenë e kanë mbetur: Politika të krimit e të gjenocidit serb ndaj shqiptarëve, duke kulmuar me pranverën e vitit 1999.

Se çfarë ka ndodhur nga pranvera e vitit 1981 deri te pranvera e 1999-s nuk ka ndonjë politikan, diplomat, intelektual apo gazetar e publicist në botën demokratike që nuk e di se si janë zhvilluar ngjarjet në Kosovë nën diktatin e udhëheqjes serbe. Për t'i kujtuar e rikujtuar këto ngjarje të dhimbshme e tragjike të kombit tim më shtynë deklaratimet e kryetarit të Serbisë, Vuçiçit, dhe të kryediplomatit serb, Daçiçit. Vuçiçi në intervistën dhënë "Guardian"-it paska thënë: "Ne jemi të gatshëm të diskutojmë çdo çështje të vetme, jemi gati të marrim parasysh çdo propozim të vetëm që do të nënkuptonte një zgjidhje kompromisi". Të gjithë në BE, në

ShBA, madje edhe Rusia (si anëtare e GK) dhe Serbia e dinë mirë se politika zyrtare e Kosovës kompromisin e madh e kanë bërë në bisedimet e Vjenës dhe të specifikuar në Dokumentin Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit Përfundimtar të Kosovës, në dokumentin zyrtar të miratuar nga vendet e përmendura.

Ndërsa tjetri, Daçiçi, paska thënë: "Askush nuk mund të na frikësojë duke na bërë shantazh. Ne do të vazhdojmë që t'ju tregojmë të gjithëve që në rastin e Kosovës kemi të bëjmë me shkëputje dhe separatizëm, të cilat janë kundër ligjeve ndërkombëtare. Serbia nuk do ta njohë këtë shtet fals". Gjithashtu të gjithë e dimë se me kërkesën e Serbisë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, e cila e ka të drejtën e interpretimit të së Drejtës Ndërkombëtare, ka konstatuar se Shpallja e Pavarësisë së Kosovës nuk bie ndesh me ligjin ndërkombëtar.

Nuk ka asnjë dyshim se këta zyrtarë të lartë serbë, në deklaratimet formale janë shumë të rezervuar me të gjithë ideologët e politikës së mitit serb që Kosovën e quajnë: "Djep serb". Por kjo që e thonë ata nuk është e saktë. E sakta është se: "Kosova është djep i krimeve dhe i gjenocidit serb". Të dhënat që e konfirmojnë këtë që e nënvizova janë të vitit 1913 dhe të thëna nga autorë të huaj, si hebreut Leo Freundlich dhe gjermanit Hans Peter Rullman si dhe letrave të ushtarëve serbë të botuara në gazetën serbe "Radnička Novine" të vitit 1913.

Hebreu Leo Freundlich shkrimin e tij të titulluar "Golgota shqiptare", në fillim në pasusin

e dytë nënvizon: "Historia e këtij populli është një vargan i pandërprerë betejash shumë të përgjakshme kundër armiqsh nga më mizorët". Kur Konferenca e Ambasadorëve në Londër e njohu Shqipërinë londineze, ushtria serbe, që gjendej në Shqipëri, do të deklaronte: "Përderisa nuk po na e lënë Shqipërinë, ne duhet t'i shfarosim shqiptarët, kjo është zgjedhja e tjetër nuk ka". Pra, sipas politikës serbe, politikë e përsëritur vetëm brenda shekullit XX, jo më pak se tri herë, "Shqiptarët duhet shfarosur"! Politika serbe, si ajo e mbretit (1913), si ajo e Jugosllavisë së Versajës dhe ajo e AVNOJ-it, e deri te Serbia e Millosheviqit (1989-1999), janë mbështetur në gjuhën e çizmes së ushtarit e xhandarit serb, për të cilën gjuhë autori Freundlich shkruan: "Gjuha e çizmes me gozhdë, e çizmes brutale e çnjerëzore të ushtarit të shfaqur në mënyrën më të lahtarshme.

Fshatra të panumërta janë rrafshuar për tokë, dhe, po kështu, një sasi e panumërt njerëzish janë therur si bagëti në kasaphanë, vetëm shtazërisht". Dhe autori vazhdon: "Një popull i tërë rrjedhë gjak atje ku e kanë kryqëzuar, por Evropa nuk pëshpërit çoftë edhe një fjalë". Nuk ka asnjë dyshim që gjendja ishte e rëndë, në çdo fshat e qytet të Kosovës, të Maqedonisë e të Shqipërisë së kohës, kudo ku sundonte çizmja e ushtarit serb.

Kjo gjendje e kishte shtyrë edhe Pierre Loti-n të thoshte: "Një popull trim, një popull të shquar, po e torturojnë të mberthyer në kryq përpara syve të gjithë botës. Por Evropa, Evropa Kristiane, Evropa e civi-

lizuar, nuk po flet qoftë edhe një fjalë për këtë. Me dhjetëra-mijëra numërohen njerëzit e pambrojtur të cilëve u ka kaluar qafa nëpër tehun e thikës e të bajonetës, gratë e përdhunuara, pleqtë dhe fëmijët e mbytur, me qindra fshatra të djegur e të rrafshuar për tokë; priftërinj të lënë pa frymë. Por Evropa vazhdon të heshtë".

Nëse e shohim atë që e thotë Bues për Ballkanin, për pasuritë e popujt e tij, më se miri e shohim se nëpër çfarë Golgote ka kaluar populli shqiptar që nga dekada e parë e shekullit XX. Sipas Hans Peter Rullman, i cili citon Buen për numrin e popujve të Ballkanit, thotë: "Serbia ka pasur më pak se nëntëqind mijë banorë, kurse Shqipëria ka pasur një milion e gjashtëqind mijë. Sipas rreptësisë se tij shkencore, në mesin e shekullit të kaluar (XIX) ka pasur më shumë shqiptarë sesa grekë dhe dy herë më shumë shqiptarë sesa serbë. Pas holokaustit të kriminuar mbi popullin shqiptar, në fillim të këtij shekulli, vargani i krimeve serbe vazhdon, me qëllim që të përfundojë krejtësisht gjenocidi mbi shqiptarët".

Dhe më pas autori me të drejtë konstaton: "Politika e denigrimit të të drejtave të nacionalitetit shqiptar është realizuar përmes mbytes fizike të sa më tepër shqiptarëve që të ishte e mundur".

Këtë që e thamë më lart më se miri e ilustron letra e ushtarit serb nga Luma dhe i cili shkruan: "Mund të them se Luma nuk ekziston më. Gjithçka është shndërruar në kufoma, hi e pluhur. Kishte fshatra me nga 100, 150 e 200 shtëpi në të cilat nuk ngeli absolutisht askush

gjallë, askush gjallë... I mblidhnin tubë, 40 deri 50 njerëz, dhe, ashtu si ishin, grumbull, i thernin të gjithë me thika. Plaçkitje ordinere u bë kudo. Oficerët plaçkitën kope të tëra bagëtish dhe i shitën përmes ushtarëve në Prizren". Ja edhe një përshkrim rrëqethës me autor Leon Trockin, parë me sytë e tij, botuar në "Kievskaja Misl", në dhjetor 1912: "Trishtimi im filloi porsa e kaluam kufirin. Në orën 5 pasdite iu afruam Kumanovës. Dielli po perëndonte dhe errësira tashmë kishte fituar terren. Sa më shumë errësohej, aq më tepër shiheshin flakët e zjarrit që shkonin përpjetë. Po digej gjithçka përreth nesh. Të gjitha fshatrat shqiptare, të afërta dhe të largëta, ishin kthyer në shtëllunga zjarri, deri te hekurudha. Ishte ky shembulli i veçantë i një lufte të tmerrshme shkatërruese që pashë në zonat e luftimeve. Në një çast, pasuria e atyre njerëzve, e trashëguar nga gjyshërit e stërgjyshërit dhe e fituar me mund, po kthehej në flakë. Kjo monotoni zjarri na përcolli gjatë gjithë rrugës deri në Shkup". Shkrimi i plotë i Leo Trockit të lë pa mend!!!

Pikërisht këto politika të krimit e të gjenocidit serb janë përsëritur edhe para e pas Luftës së Dytë Botërore dhe kulmi i saj është arritur në luftën e fundit 1998-1999. Pa dyshim se më e dhimbshmja është se këto politika të gjenocidit me gjakftohtësi hardhuce kanë mbetur të pandëshkueshme. Si rezultat i kësaj, politika e sotme serbe jo vetëm se nuk është penduar, por vazhdon me kërcënime të reja ndaj Kosovës si djep i gjenocidit serb!

## Shkolla 'Hasan Prishtina' shënon 50-vjetorin e themelimit

PRISHTINË, 27 PRILL (ER) - Shkolla Filllore dhe e Mesme e Ulët "Hasan Prishtina" ka shënuar 50-vjetorin e themelimit të premten në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë. Në këtë aktivitet kanë marrë pjesë nxënës, mësues e ish-mësues të kësaj shkolle, drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës, Jonuz Salihaj, ish-nxënësi i kësaj shkolle, tani shef i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK-së) në Kuvendin e Kosovës, Memli Krasniqi, për-

faqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, Gani Demaj dhe përfaqësues të KFOR-it. Drejtoresha e shkollës "Hasan Prishtina", Sofije Bunjaku, ka përshkuar rrugën e gjatë të kësaj shkolle dhe të arriturat e saj deri më sot. Nga një fjalë rasti në shënimin e 50-vjetorit të shkollës "Hasan Prishtina" kanë mbajtur edhe drejtori i Arsimit në Komunën e Prishtinës, Jonuz Salihaj dhe shefi i grupit parlamentar i PDK-së, Memli Krasniqi.



## Tusk: Koreja dhe Ballkani tregojnë se e pamundura bëhet e mundur

**BRUKSEL, 27 PRILL** - Presidenti i Këshillit Evropian, Donald Tusk, tha se lajmet nga Gadishulli Korean dhe ajo që ka përjetuar në Ballkan ditët e fundit, tregojnë se "e pamundura mund të bëhet e mundur". "Ajo çfarë kam dëgjuar sot nga

Koreja dhe ajo që kam përjetuar në Ballkan ditët e fundit do të duhej të ishte përkujtues pozitiv për të gjithë, se e pamundura mund të bëhet e mundur dhe se gjithçka varet tërësisht nga vullneti i mirë dhe guximi i individëve", tha Tusk

në "Twitter".

Tusk ka vizituar këtë javë vendet e Ballkanit Perëndimor, ku ka përçarur mesazhin se Bashkimi Evropian është dhe mbetet partneri i tyre më i besueshëm. Tusku, po ashtu, i ka siguruar ato se kanë të

ardhme evropiane, nëse i përmbushin kriteret. Të premten dy Koretë janë zotuar se do ta denuklearizojnë plotësisht Gadishullin Korean dhe kanë thënë se presin që fundi zyrtar i luftës të shpallet deri në fund të vitit.



## Koretë pajtohen për paqe të përhershme

Në takimin e parë mes dy Koreve, në më shumë se një dekadë, të dyja palët thanë se do të kërkojnë një marrëveshje për ta vendosur paqen e përhershme dhe të qëndrueshme në gadishull

**WASHINGTON, 27 PRILL** - Presidentët e dy Koreve u pajtuan ta çlirojnë gadishullin nga armët bërthamore, por nuk ofruan asnjë hollësi për hapat që do të merren për të arritur këtë synim. Në një deklaratë të përbashkët pas bisedimeve të së premtës ndërmjet udhëheqësit të Koresë së Veriut, Kim Jong Un dhe presidentit të Koresë së Jugut, Moon Jae-in, dy vendet konfirmuan synimin e tyre për të siguruar një gadishull korean të lirë nga armët bërthamore. Në takimin e parë, në më shumë se një dekadë, të dyja palët thanë se do të kërkojnë një marrëveshje për ta vendosur paqen e përhershme dhe të qëndrueshme në gadishull. Bisedimet ndërmjet dy udhëheqësve ishin serioze dhe miqësore, thanë zyrtarët e Koresë së Jugut. Jugu citoi udhëheqësin e Koresë së Veriut të ketë thënë se "ne

duhet ta vlerësojmë këtë mundësi në mënyrë që plagët midis Jugut dhe Veriut të shërohen".

Më herët të premten, Kimi shprehu interesimin për ta vizituar Korenë e Jugut dhe rezidencën presidenciale, Blue House. Të dy udhëheqësit patën një shtrëngim të ngrohtë duarsh në vijën kufitare që ndanë të dyja vendet, para se të fillonin takimin.

Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, kaloi pastaj kufirin me presidentin e Koresë së Jugut, Moon Jae-in.

"Jam i lumtur t'ju takoj", tha presidenti Moon.

Pastaj Kimi e ftoi presidentin Moon të kalojë për pak çaste në veri para se të ktheheshin në anën jugore.

Kjo është hera e parë që një anëtar i dinastisë Kim shkel në jug që nga fundi i luftës së Koresë në vitin 1953.



Presidenti amerikan Donald Trump reagoi të premten në "Twitter" lidhur me takimin historik mes dy Koreve, duke shkruar: "Lufta Koreane po merr fund". "ShBA-ja dhe i gjithë populli i saj i madh duhet të jenë shumë krenarë për atë që po zhvillohet tani në Kore" shkruante Trumpi. "Gjëra të mira po ndodhin, por vetëm koha do të

tregojë", shkruante ai të premten në mëngjes.

Shtëpia e Bardhë lëshoi një deklaratë të enjten vonë, pak pasi dy udhëheqësit shtrënguan duart. "Ne shpresojmë që bisedimet do të arrijnë përparim drejt një të ardhmeje paqësore dhe përparimi për tërë Gadishullin Korean. Shtetet e Bashkuara vlerësojnë

bashkëpunimin e ngushtë me aleatin tonë, Republikën e Koresë dhe shpresojmë që diskutimet e vazhdueshme të jenë në funksion të përgatitjeve për takimin e planifikuar midis presidentit Donald Trump dhe Kim Jong Un, në javët e ardhshme", thuhej në deklaratë.

Kimi dhe presidenti Trump pritet të takohen në maj apo në qershor.

## Trumpi viziton Britaninë e Madhe në korrik



Washington, 27 prill - Presidenti amerikan Donald Trump do ta vizitojë Britaninë më 13 korrik, pasi më herët anuloi udhëtimin duke pretenduar se do të përballlej me protesta masive. BBC raporton se nuk do të jetë një vizitë e plotë shtetërore, ashtu siç Trumpi i premtoi Theresa Mayt në janar në Shtëpinë e Bardhë. Por, ftesa për një vizitë zyrtare qëndron ende. Sipas BBC-së, ka gjasa që Donald Trumpi të takohet edhe me mbretëreshën. Trumpi dhe May do të diskutojnë një sërë çështjesh me rëndësi, por ende nuk jepen detaje rreth kësaj. Data në korrik, pason samitin e NATO-s në Bruksel, ku presidenti Trump pritet të marrë pjesë.

Downing Street dhe Shtëpia e Bardhë kishin shpresuar të koordinonin zbulimin e detajeve të udhëtimit, por zëdhënësja e Trumpit, Sarah Sanders, me sa duket e zgjidhi gojën më herët. Ambasadori britanik, Sir Kim Darroch, po ashtu konfirmoi datën në "Twitter", duke thënë se ishte i kënaqur që Trumpi do ta vizitonte Britaninë e Madhe. Theresa May ishte e para lidere e huaj që vizitoi Trumpin në Shtëpinë e Bardhë, pas inaugurimit të tij në janar 2017. Ajo i dorëzoi një ftesë nga Mbretëresha, për një vizitë shtetërore, një okazion formal me shumë pompozitet dhe ceremoni.

## Mike Pompeo në takimin e NATO-s

**BRUKSEL, 27 PRILL** - Sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, i sapokonfirmuar në detyrë, mbërriti të premten në Bruksel për takimin e ministrave të jashtëm të NATO-s. Çështja e Rusisë do ta kryesojë rendin e ditës në takimin që zhvillohet, ndërkohë që vendet perëndimore kanë akuzuar Moskën për

helmimin e një ish-spiuni në Britani. Tensionet u rritën më tej pas sulmit të dyshuar me armë kimike të aleatit të Rusisë, Sirisë dhe goditjeve ajrore perëndimore që pasuan.

Vetëm 12 orë pasi bëri betimin në postin e sekretarit të Shtetit, Mike Pompeo mbërriti në selinë e NATO-s në atë që aleatët evropi-

anë e shohin si mbështetje të fortë për një institucion që presidenti amerikan Donald Trump e kishte quajtur të vjetruar.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha se fokusi i takimit do të ishte ajo që ai e quajti "sjellje e rrezikshme" e Moskës. "Kjo përfshin aneksimin e paligjshëm të Krimesë, destabiliz-

imin e Ukrainës Lindore, ndërhyrjen në proceset demokratike, sulmet kibernetike dhe dezinformimin", tha Stoltenbergu. Takimi i ministrave të NATO-s do ta hapë rrugën për një samit të udhëheqësve të aleancës në korrik. Një zyrtar i Departamentit të Shtetit tha se takimi do të përqendrohet në atë që ai e cilësoi



si agresioni i Rusisë në Ukrainë, Gjeorgji dhe Siri, si dhe planet për rritjen e sigurisë përgjatë kufirit jugor të Evropës.

# Shqipëria, media e saj dhe Pranvera e vitit 1981 në Kosovë



Bedri ISLAMI

Pa as më të voglin dyshim, viti 1981 dhe sidomos pranvera e tij, ka qenë viti i provës për shqiptarët e Kosovës. Përgjithësisht, secila dekadë e ka gurin e vet themeltar ose, më saktë, ka një datë ose një moment të caktuar, që vendos pikëmbështetjet e së ardhmes. Për shqiptarët në Kosovë ka ndodhur disi ndryshe: një ngjarje ka mbajtur mbi vete më shumë se dy dekada dhe, si duket, do të vazhdojë të mbajë mbi vete edhe shumë vite të tjerë. Demonstratat e pranverës, mars - prill 1981, janë pikënyja e viteve që erdhën më pas dhe, si të tilla, kanë mbetur në kujtesën e kombit dhe në dëshminë historike të tij.

Prej këtij viti, duam apo nuk duam, jemi të vetëdijshëm ose jo, kanë rrjedhur të gjitha ngjarjet e tjera madhore që lidhen me Kosovën dhe, një pjesë e rëndësishme e tyre, edhe me Shqipërinë londineze.

Kryengritja shqiptare në ish-Jugosllavi, në fillimin e viteve '80-ta ka qenë pa dyshim, njëra nga ngjarjet, rreth së cilës e për të cilën janë bërë analiza të shumta, me të janë marrë e sigurisht do të merren njerëz të mendimit nga të gjitha fushat, por njëkohësisht edhe spekulantë; janë marrë shkrimtarë e sociologë, historianë, protagonistë, gazetarë, janë ringritur ngjarjet, duke filluar që nga mbremja e 11 marsit dhe deri tek arrestimet masive, janë ngritur teza të ndryshme,

hipoteza të sakta e nga më të çuditshmet, ka pasur gjykime e paragjykime, hamendje nga më të çuditshmet dhe nga më të pazakonshmet, ka pasur fillimisht çirre dhe përbaltim institucional, diferencim masiv, pastaj heshtje, por kurrë mbrojtje institucionale në Kosovë.

Tezat, hipotezat, pikëpyetjet, hamendjet, thëniet, gjykimet dhe debatet nga më të ashprat dhe nga më të vrullshmet, kanë qenë për rolin dhe qëndrimin e shtetit shqiptar.

Që në fillim janë hedhur të gjitha pyetjet e mundshme dhe janë synuar të gjitha dilemat e hipotekuara. Në të vërtetë është bërë përpjekja, herë serioze dhe herë e rreme, për të sqaruar disa nga momentet më thelbësore të qëndrimit të shtetit shqiptar ose për të përbaltur ato. Pak ose aspak janë bërë përpjekje për të ditur gjykimin e njerëzve të zakonshëm në Shqipëri, të mendimit intelektual, si i kanë pritur ata ngjarjet e pranverës kosovare, si kanë depërtuar ato në thelbin e jetës së tyre të zakonshme; ishte merak spontan, njerëzor ose i organizuar, apo e vërteta qëndron diku në mesin e tyre? Kishte më shumë se hall, brengë, shqetësim a mërzë, kishte diçka më shumë vetes dhe përtej së zakonshmes, kishte thjeshtë brengë njerëzore apo edhe kombëtare...?

Natyrisht, për cilindo lajm përbën dilema e shtruar atëherë, nëse kishte dijeni Shqipëria zyrtare për atë që po përgatitej të ndodhte në Kosovë? A kishte dijeni Enver Hoxha, përmes strukturave të tij, se viti 1981 do të ishte njëkohësisht edhe viti i kryengritjes shqiptare? A ndikuan strukturat e fshehta të shtetit shqiptar në organizimin apo thjesht nxitjen e kryengritjes dhe afishimin e parullës Kosova-Republikë; apo të thirrjes tjetër "Republikë,

Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë". A kanë qenë të përgatitura dhe të instruktura organizatat ilegale, që u vunë në ballë të demonstratave nga strukturat e fshehta të shtetit shqiptar? A kishte në Tiranën zyrtare përkrahjen e duhur kërkesa për republikën e Kosovës apo shteti shqiptar ishte kundër krijimit të një shteti të dytë shqiptar në Ballkan? Përkrahja e shtetit shqiptar ishte e vonuar apo në kohën e duhur? E gjithë ajo që ndodhi në polemikën e madhe mes shtetit shqiptar dhe shtetit jugosllav ishte thjeshtë një retorikë ideologjike apo pas saj fshihej edhe çështja kombëtare...

Mbi të gjitha cili ishte roli i shtypit dhe i mediave shqiptare, të cilat, dashje pa dashje, pasqyronin vijën e dhënë nga shteti shqiptar dhe në këtë mënyrë, nëse dikush kërkon të shohë se çfarë qëndrimi mbajti Shqipëria e atyre viteve, mbështetjen e parë, shikimin e parë e ka pikërisht tek qëndrimi i mediave të saj.

Unë do të mendohej të sjell disa nga përjetimet e njëzet e shtatë viteve më parë, ashtu si i kam përjetuar unë, qoftë si qytetar i zakonshëm, qoftë si gazetar. Por, edhe ata që kam mësuar nga bisedat me kolegë më të vjetër dhe më pranë regjimit të kohës. E di se për disa do të jetë disi e pazakontë, ndoshta edhe jashtë rrjedhës së trysnisë politike që përçohet ndaj shtetit shqiptar të atyre viteve, mirëpo unë do bëj mundim të sjell atmosferën ashtu si ishte në ato ditë, ashtu si është përjetuar nga unë dhe njerëzit rreth meje, nga shokët e mi gazetarë, por edhe nga njerëzit e shquar të artit, shkencës, historisë. Do t'ia lejoj vetes që, ashtu si i kam ndjekur dhe ashtu si i kam analizuar më pas, ta sjell edhe mendimin tim

për ato që ishin asokohe në mendimin politik zyrtar, duke shfrytëzuar të drejtën nga takimet e mëpasshme që kam pasur me disa nga protagonistët në Shqipëri të këtyre ngjarjeve, mes të cilëve edhe me ish presidentin e Shqipërisë, Ramiz Alia. Të gjitha këto nuk i sjell për të nxitur një mendim ndryshe ose një mendim "për", por të sjell, sado pak, ato të vërteta që ose janë thënë ndryshe, ose janë thënë të cinguar.

Le të nisim me atë që përjetuan gazetarët dhe njerëzit e zakonshëm...

Njëri ndër gazetarët më të vjetër më tregonte: "Në mesin e muajit mars të vitit 1981, ata që punonin një kat më poshtë në redaksinë e gazetës "Zëri i Popullit" vunë re se, në sektorin e jashtëm, i cili ishte në katin e sipërm, kishte një lëvizje më të shumë se të zakonshme, kishte një lëvizje përgjithësisht më të ndjeshme se herët e tjera. Zakonisht ndodhte kështu, kur kishte ngjarje të rëndësishme. Aq më tepër se, shumë më shpesh se më parë, kishin filluar të vinin funksionarë të rëndësishëm të aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, të cilët, jo radhë herë, nuk ndaleshin as në zyrën e kryeredaktorit të gazetës, që ndodhej në katin e dytë. Megjithatë, nuk ishte vërejtur ende asgjë e jashtëzakonshme nëpër radhët e artikujve, të cilët, në më të shumtën e rasteve, nuk kishin ndonjë gjë të veçantë. Edhe fakti që, përgjegjësi i sektorit ë jashtëm, ishte thirrur dy herë, brenda ditës, tek shefi, nuk përbënte ndonjë lajm, sepse kjo kishte qenë shpesh një rutinë e zakonshme.

Zakonisht, nga ora nëntë e mëngjesit, djemtë e gazetës, si i thërrisnin miqtë e tyre të afërt, mes të cilëve edhe kryeministri i djeshëm i Shqipërisë, Berisha,


shkonin të pinin kafënë e mëngjesit, në kafenenë e Lidhjes së Gazetarëve, ku kishte më shumë zhurmë se në të gjitha kafenetë e tjera. "Zhurmëtarët" zakonisht ishin Pëllumb Bato i "Bashkimit", (nuk e di se ku është tani), Filip Çakulli i "Hostenit", i cili kishte zakonisht një mosmarrëveshje në javë me shefin e tij dhe të kritikuarit prej tij, dhe shefi i sotëm i gazetës thellësisht pëdëiste, Fahri Balliu, që aso kohe ishte gazetar special i "Zërit të Popullit" dhe i udhëheqjes së lartë politike. Ishte vënë re se prej dy ditësh, gazetarët e sektorit të jashtëm të "Zërit të Popullit" apo të "Bashkimit" ose nuk po vinin fare, ose pinin një kafe, tepër shpejt dhe ikin. Ndërsa ato të RTSh-së, sektori i jashtëm, që vinin nganjëherë për kortezi gazetareske, meqë kishin klubin e tyre, nuk dukeshin".

Përgjithësisht, në sektorët e jashtëm të shtypit punonin asokohe gazetarë nga më të mirët, të aftë dhe patriotë, si u dëshmuar shumë prej tyre në vitet që erdhën. Në "Zëri" ishte i njohur Shaban Murati, në "Bashkimi" ishte Napoleon Roshi, në RTSh ishte Bujar Muharremi. Megjithatë, fjalët kishin filluar të rridhnin, më shumë jo nga kanalet zyrtare, sa nga "rebelët" që ndiqnin herë pas here, kanalet radiofonike të huaja. Kishte filluar të flitej se në Prishtinë kishte pasur demonstrata një apo dy ditë më parë, mirëpo nuk dihej më tepër. Njëri nga shokët e mi, që kishte qëndruar deri vonë për të ndjekur thaujse të gjitha stacionet radiofonike që mund t'i kuptonte, më tha, se në Prishtinë kishte pasur një demonstrim të studentëve, por ajo kishte qenë për kushte më të mira jetese dhe ushqimi dhe, si duket, nuk kishte pasur asgjë politike. (Vijon)

## 'Kurban' përkthehet në italisht

TIRANË, 27 PRILL - Libri "Kurban" i kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, ka gjetur dritën e botimit edhe në Itali. Lajmin e ka bërë me dije vetë Rama përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook": "Me librin e sapodalë në libraritë italiane ju uroj një ditë të mbarë". Parathënia e përkthimit është

shkruar nga gazetarja, shkrimtarja dhe autorja televizive, Daria Bignardi. Në kopertinën e librit është fotoja e Edi Ramës, shoqëruar me shkrimin "Ishte viti 2000, kur Tirana nuk ishte aspak ajo që është sot". Libri "Kurban" i kryeministrit Rama është përkthyer edhe në turqisht.



**E rrallë**

# 23-vjeçari i 'bllokuar' brenda trupit të një foshnje

Një gjendje misterioze ka lënë një 23-vjeçar të 'bllokuar' brenda trupit të një fëmije në Indi. Djali shihet nga vendësit si një mishërim i Perëndisë. Manpreet Singh, i quajtur 'njeri me përmasa të vogla' nga fqinjët e tij në Hisar,



peshon vetëm 4.9 kg pavarësisht se ka lindur në vitin 1995.

**FOTO E DITES**



Një fermer pakistanez shihet duke korrur grurë në një fushë në periferi të Lahores. /AFP/

**E jashtëzakonshme**

# Gishti i të vdekurit përdoret për ta zhbllokuar telefonin

Policia në Florida është kritikuar pasi dyshohet se ka hyrë në shtëpinë e funeraleve në një përpjekje të kotë për ta zhbllokuar telefonin e një burri të vdekur. Linus Phillip, 30 vjeç, u vra derisa përpiqej të arratiset nga policia në një stacion benzine në Largo më 23 mars. Pasi trupi i tij u



dërgua në shtëpinë e funeralit të Abbey Sylvan, sipas familjes së tij, dy policë u përpoqën ta përdornin gishtin e tij për t'i zhbllokuar telefonin.

**BARSOLETA E DITËS**



**Babi:** Ku po ikën, moj bijë, në gjysmë të natës?

**Vajza:** Në banjë, babi, se më duhet urgjentisht një fotografi e re profili.



**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:30

## “BLACK PANTHER” 3D (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 2 orë 15 min

Rolet: Chadwick Boseman, Angela Basset, Michael B. Jordan, Lupita Nyong'o, Martin Freeman, Forest Whitaker, Andy Serkis, etj.  
Regjia: Ryan Coogler



Në ora 17:00

## “PETER RABBIT”

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 33 min

Rolet: James Corden, Rose Byrne, Domhnall Gleeson, Sam Neill, Daisy Ridley, Elizabeth Debicki, Margot Robbie, etj.  
Regjia: Will Gluck



Në ora 19:00

## “PACIFIC RIM UPRISING” (PG-13)

Aksion/Aventurë/Fantastiko-Shkencor; 1 orë 51 min

Rolet: John Boyega, Scott Eastwood, Jing Tian, Cailee Spaeny, Rinko Kikuchi, Burn Gorman, Adria Arjona, Charlie Day, etj.  
Regjia: Steven S. DeKnight



Në ora 21:00

## “RED SPARROW” (R)

Mister/Triller; 2 orë 25 min

Rolet: Jenifer Lawrence, Joel Edgerton, Matthias Shoenearts, Jeremy Irons, Mary-Louise Parker, Charlotte Rampling, etj.  
Regjia: Francis Lawrence



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**




**DASHI**

Mund të kaloni një ditë të këndshme me një njeri të pasionuar pas artit. Me këtë person do të kaloni çaste speciale.



**DEMI**

Stresi do t'ju bëjë të mos mendoni me shumë kthjelltësi. Për këtë arsye do të ishte mirë të bënit një shëtitje gjatë pasdites.



**BINJAKËT**

Ka tension përreth jush. Atmosfera e ashpër është në kontrast me dëshirat tuaja. Kini durim dhe shmangni konfrontimet.



**GAFORRJA**

Mos luftoni me ndjenjat tuaja. Merrni në konsideratë të gjithë faktet përpara se ta thoni fjalën e fundit mbi një çështje.



**LUANI**

Kohët e fundit keni bërë veprime të ngutshme, por të drejta. Mos u ndjeni në faj për këtë, por shijojeni në maksimum.



**VIRGJËRESHA**

Një mik i juaji ka disa ide të jashtëzakonshme, por edhe shumë të çuditshme për të fituar para. Mos u përfshini në këto plane.



**PESHORJA**

Mund të jeni shumë i paduruar me veten tuaj gjatë ditës së sotme. Mos keni frikë të pyesni të tjerët për çështje që ju shqetësojnë.



**AKREPI**

Përpjekjet për t'i balancuar emocionet me logjikën mund të mos funksionojnë, veçanërisht kur është e përfshirë edhe familja.



**SHIGJETARI**

Do t'ju lindin ide të reja të cilat do të jenë shumë të vlefshme. Mos hezitoni t'i përdorni ato, sepse do të kuptoni se do të përfitonit shumë.



**BRICJAPI**

Një mbrëmje me miqtë do të rezultojë emocionuese. Mund të bëni një njohje me një person të rëndësishëm.



**UJORI**


Duhet të bëni disa kërkime dhe hulumtime të nevojshme për të përfunduar një studim. Puna që po bëni do të sjellë rezultate pozitive për ju.



**PESHQIT**

Çështjet e karrierës mund të rezultojnë shumë stresuese për ju. Përpiquni ta merrni jetën me lehtësi.

## Mike Posneri e kujton Aviciin



**M**ike Posner është duke u përballur me vdekjen e Aviciit dhe ka thënë se kjo ngjarje është një rikujtim që asgjë nuk zgjatë përgjithmonë. Ai ka thënë se dëshiron që shoku i tij të mbahet në mend për muzikën që ka


bërë. Kënga "I Took A Pill In Ibiza", teksti i së cilës e përmend Aviciin, tani ka kuptim shumë më të madh për Posner. Mike Posner i kishte kushtuar një performancë Aviciit gjatë koncertit të tij në Coachella, pikërisht me këtë këngë.

## Zonja e Parë e ShBA-së feston ditëlindjen



**P**residenti i Amerikës, Donald Trump, ka zbuluar dhuratën që i ka bërë bashkëshortes së tij, Melania Trump, për ditëlindjen e saj të 48. Në një intervistë për "Fox and Friends Thursday" nuk i ka shpëtuar pyetjes se cila është

dhurata që i ka bërë Zonjës së Parë, për të cilën tha: "Ndoshta nuk i bleva shumë. Po ju tregoj se i dhurova një kartë të bukur. Jam shumë i zënë për të blerë dhurata. I mora dhe lule të bukura", ka deklaruar presidenti Trump.



## Gigi dhe Bella Hadid shkëmbejnë puthje

**D**y motrat Bella dhe Gigi Hadidi kanë tërhequr vëmendjen e të gjithëve në premierën Being Serena në Nju Jork. Të veshura plot stil supermodelet shkëlqyen në pre-

mierë. Gigi mbante veshur një kostum ngjyrë kremi, kurse motra e vogël Bella kishte kombinuar klasiken me sportiven. Ajo mbante veshur një kostum të zi, bluze dhe atlete të bardha.

## Aktori i njohur Bill Cosby u shpall fajtor në gjyq për "ngacmim seksual"



**K**omediani amerikan Bill Cosby u shpall fajtor për tri akuza për ngacmime seksuale, ku secila përmban 10 vjet burgim. Aktori 80-vjeçar ishte në gjykatë si i pandehur me pretendimin se ka droguar, më pas

ngacmuar seksualisht ish-basketbollisten Andrea Constand në 2004-n. Cosby, aktori i parë i famshëm me ngjyrë, do të mbetet jashtë burgut deri në përfundim të gjykimit në shkallët më të larta të gjyqësorit, urdhëroi gjyqtari.

**EURO GLASS**  
SAINT-SOMBAIN  
SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com

**Sport**

**QENDRA SPORTIVE**  
"BUJQËSIA"  
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

NEWCASTLE - WEST BROM

1

ASTON VILLA - DERBY

1

SOCIEDAD - ATHLETIC BILBAO

1

# Prishtina nuk dëshiron të lejojë befasi kundër Llapit

Prishtina është e përgatitur maksimalisht që mos të lejojë befasi në ndeshjen kundër Llapit e cila zhvillohet të dielën në Pejë. "Synimi ynë është titulli, prandaj nuk bën të gabojmë kundër Llapit, që është kundërshtar mjaft i fortë, i organizuar mirë dhe me lojtarë cilësorë", ka thënë Fetahaj. Për tri pikë ka paralajmëruar se do të luajë edhe skuadra e Llapit



**EPOKA E RE** **Veton ZYMBERI**

**PRISHTINË, 27 PRILL** - FC Prishtina vazhdon të jetë konkurrentja kryesore e Dritës në garën për titull të kampiones në Vala Superligën e Kosovës në futboll. Futbollisti Liridon Fetahaj ka thënë për gazetë se Llapi ka skuadër të mirë, por tri pikët do t'i takojnë skuadrës kryeqytetase për faktin se është e vetmja mënyrë për ta vazhduar rrugëtimin drejt titullit. "Synimi ynë është titulli, prandaj nuk bën të gabojmë kundër Llapit që është një kundërshtar mjaft i fortë, i organizuar mirë dhe me lojtarë cilësorë", ka thënë Fetahaj. Prishtina nga 28 ndeshje ka grumbulluar 53 pikë, kurse ka regjistruar 15 fitore, 8 barazime dhe 5 humbje. Kundërshtari i Prishtinës, Llapi, pas humbjes në fundjavën e kaluar nga Drita në stadiumin

"Zahir Pajaziti" në Besianë (1-3), synon të këndellët në ndeshjen që zhvillohet të dielën në Pejë. Skuadra e Tahir Batatinës, që ishte kampione e vjeshtës, ende nuk ka hequr dorë nga titulli, ani pse diferenca me skuadrën kryesuese është 12 pikë. Këtë e ka konfirmuar për "Epokën e re", Dardan Jashari. "Për ndeshjen ndaj Prishtinës nuk jemi të kompletuar, por kemi synime të mëdha. Përballë e kemi një skuadër të fortë që ka futbollistë cilësorë, por si në çdo ndeshje tjetër hyjmë për fitore", ka thënë Jashari. Skuadra e Llapit aktualisht renditet në pozitën e tretë me 45 pikë të grumbulluara, ku nga 28 ndeshje të zhvilluara, regjistroi 13 fitore, 6 barazime dhe 9 humbje. Të shtunën në kuadër të elitës zhvillohen dy ndeshje: Liria-Gjilani dhe Drenica-Vllaznia, kurse të dielën nga ora 16:00, krahas ndeshjes

Prishtina-Llapi, zhvillohen edhe tri ndeshje të tjera: Trepça '89-Flamurtari, Drita-Feronikeli dhe Vëllaznimi-Besa.

## Vala SUPERLIGA

**Të shtunën takohen:**  
Liria-Gjilani  
Drenica-Vllaznia e Pozharanit

**Të dielën takohen:**  
Trepça '89-Flamurtari  
Drita-Feronikeli  
Prishtina-Llapi  
Vëllaznimi-Besa

## LIGA E PARË

**Të shtunën takohen:**  
Fushë Kosova-Bashkimi (K)  
2 Korriku-Hajvalia

**Të dielën takohen:**  
Dukagjini-Ballkani  
Vushtrria-Kika  
Trepça-KEK-u  
Vitia-Ramiz Sadiku  
Ferizaj-Kosova (P)

## SHKURT

### "Ekonomia" e mposhti në finale "Gjin Gazullin"

Ekipi i Shkollës së Mesme "Ekonomia" e ka mposhtur në finale ekipin e Shkollës së Mesme "Gjin Gazulli" me rezultat 1-0. Ekipi i "Ekonomisë" ishte më i përgatitur nga të gjitha ekipet e shkollave të mesme të Prishtinës, prandaj edhe me meritë u shpall ekipi më i mirë. Finalja e zhvilluar të premtën në fushën e Qendrës Sportive "Bujqësia" solli një lojë mjaft të fortë dhe në fund triumfuese doli "Ekonomia", e cila u shpërblye edhe me medalje dhe Kupë.

### Lipjani në Superligë, Istogu në Ligën e Parë

Lipjani është anëtar i ri i IP Superligës së Kosovës në basketboll. Pavarësisht prej disfatës së pësuar nga Kalaja në Prizren me rezultat 70:73, falë fitores në ndeshjen e parë me pesë pikë epërsi (76:71), Lipjani është shpallur kampion i Ligës së Parë dhe e ka siguruar inkuadrin në rangun më të lartë të basketbollit kosovar. Ndërkaq Kalaja tani do të luajë në "play-out" kundër Boreas. Skuadra e Istogut e ka siguruar një vend në një rang më të lartë të garave. Istogu, pavarësisht prej disfatës së përjetuar nga Don Bosko në ndeshjen e dytë finale të "play-off"-it të Ligës së Dytë të Meshkujve, ka arritur të shpallet kampion, pasi që në ndeshjen e parë kishte triumfuar me 11 pikë epërsi (66:55), kurse në takimin e dytë ka përjetuar humbje me 8 pikë dallim (65:57). Sipas propozicioneve të garave të FBK-së, kampion i Ligës së Dytë të Meshkujve shpallet ekipi, i cili në njërën ndeshje shënon fitore me më shumë pikë, ose pëson humbje me më pak pikë sesa që ka fituar ndeshjen e parë.

### Challandesi në Kosovë për ndeshjet e Superligës

Trajneri i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Bernard Challandes, pritet të vijë në Kosovë gjatë këtyre ditëve. Në një intervistë për faqen zyrtare të FIFA-s, zvicerani ka folur për Përfaqësuesen e Kosovës. "Tani jam duke shkuar në Kosovë dhe do t'i ndjek nga afër disa ndeshje. Kemi ekipin me moshën mesatare shumë të re, 22-23 vjeç, që do të thotë se këta futbollistë do të arrijnë diçka të madhe në të ardhmen. Gjithashtu, kemi U21-shat që ndalën Gjermaninë në barazim pa gola dhe U19 që po fiton disa ndeshje", ka thënë Challandes. Tekniku zviceran foli edhe për fillimin e tij tek Përfaqësuesja e Kosovës ku mori dy fitore ndaj Madagaskarit 1-0 dhe ndaj Burkina Fasos 2-0. "Sigurisht se ishte një fillim ideal për mua dhe për ekipin pas kampit që organizuam në Francë. Ne kemi shumë futbollistë të mirë që luajnë nëpër gjithë Evropën, por tani duhet të luajmë si grup", ka deklaruar Challandes.

## Akili mbetet pa medalje, sot garon Loriana Kuka

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Xhudisti Akil Gjakova nuk ka mundur ta ndjekë rrugën e motrës së vet, Nora Gjakovës, e cila fitoi medaljen e artë dhe të Distria Krasniqit, që fitoi të

argjendtën, në Kampionatin Evropian "Tel Aviv 2018". Akili u mposht në repesazh nga armeni Arsen Ghazaryan në kategorinë -57 kilogramë. Gjakova përfun-

doi në mesin e tetë garuesve më të mirë në këtë kampionat, nga 41 sosh. Duhet cekur se sot (e shtunë) do të garojë Loriana Kuka në kategorinë -78 kilogramë.





## Dreshaj krenohet me suksesin e KB Istogu

**BURIM, 27 PRILL** - Deputeti i Kuvendit të Kosovës, Gani Dreshaj, e ka përshëndetur suksesin e KB Istogu, i cili është inkuadruar në Ligën e Parë të Kosovës në basketboll.

Dreshaj ka premtuar se do të vazhdojë ta përkrahë këtë klub edhe në të ardhmen. "Krenar me suksesin e arritur nga Klubi i Basketbollit, Istogu. Skuadra jonë e qytetit

është ngritur në një nivel më të lartë duke zhvilluar edicion të jashtëzakonshëm nën udhëheqjen e maestro, Fikret Shatrit. Përgëzime djelmoha! Ju premtoj se do të jem

përsëri krah i juaji duke mos ju lënë asnjëherë vetëm. Jeni shembulli më i mirë i një storie pune dhe sukcesi", ka shkruar Dreshaj në "Facebook".



# Iniesta konfirmon largimin nga Barcelona

"Ndihem krenar dhe i qetë, pasi objektivi im i vetëm ishte të triumfoja në këtë klub dhe ia kam arritur. I kam dhënë gjithçka klubit si futbollist dhe si njeri", ka thënë Andres Iniesta

**Barcelonë, 27 prill** - Ylli i futbollit spanjoll, Andres Iniesta, ka njoftuar në një konferencë për shtyp, se ky do të jetë sezoni i tij i fundit me Barcelonën, duke vërtetuar zërat që kishin disa javë që qarkullonin për largimin e tij. Me lot në sy gjatë gjithë prononcimit të tij, mesfushori spanjoll bëri me dije se është i lumtur që ka kaluar të gjithë karrierën në elitë, me një skuadër si Barcelona. "Ndihem krenar dhe i qetë, pasi objektivi im i vetëm ishte të triumfoja në këtë klub dhe ia kam arritur. I kam dhënë gjithçka klubit, si futbollist dhe si njeri", ka thënë Iniesta.

Në 30 qershor mesfushori do të jetë zyrtarisht një futbollist i lirë. Ajo që nuk dihet akoma është skuadra me të cilën do të luajë nga 30 qershori e më tej, por mendohet se do të nënshkruajë një kontratë trevjeçare me një klub kinez. Në kampionatin kinez, ndërkohë që do të luajë,



do të krijojë edhe kampe futbolli për fëmijë. Vetë Iniesta nuk i konfirmoi këto zëra, duke thënë vetëm se, përveçse në Evropë,

mund të luajë kudo tjetër. "E përjashtoj Evropën pasi nuk dua të përballem me Barcelonën", ka shtuar Iniesta.

# Milwaukee mposhti Bostonin

**MILWAUKEE, 27 PRILL** - Milwaukee fitoi 97-86 ndaj Bostonit në çerekfinalen e shtatë të "play-off"-it në Konferencën e Lindjes, duke barazuar 3-3 serinë e takimeve mes dy ekipeve. Edhe pse u mendua se Celticsi do ta kishte të lehtë në këtë fazë, mungesa e Irvingut ka ndikuar shumë. Bostoni dominoi në ndeshje në pjesën e parë (Tatum 22 pikë), por në pjesën e dytë vendësit u treguan më të saktë, duke përmbysur disavantazhin e skuadrës mike. Antetokounmpo me 31 pikë e 14 rebaunde ishte lider në fushë për Bucksin, duke mbajtur gjallë shpresat e ekipit të tij për t'u kualifikuar në fazën gjysmëfinale. Deri më tani, një biletë për më tej kanë prerë Philadelphia (Lindje), Houstoni, Golden State e New Orleansi (Perëndim).



### KONFERENCA E LINDJES

1-8 Toronto - Washington	(3-2 me ndeshje)
2-7 Boston - Milwaukee	86-97 (3-3 me ndeshje)
3-6 Philadelphia - Miami	(4-1 me ndeshje)
4-5 Cleveland - Indiana	(3-2 me ndeshje)

### KONFERENCA E PERËNDIMIT

1-8 Houston - Minnesota	(4-1 me ndeshje)
2-7 Golden State - San Antonio	(4-1 me ndeshje)
3-6 Portland - New Orleans	(0-4 me ndeshje)
4-5 Oklahoma - Utah Jazz	(2-3 me ndeshje)

## SHKURT

### Emery largohet nga PSG-ja

Unai Emery ka njoftuar se në fund të këtij edicioni do të largohet nga skuadra e Paris Saint-Germain. "Unë pata një takim vetë i tretë, me Antero dhe Al-Khelaifi. Aty vendosëm se ishte më e mirë për të gjithë të vepronim kështu. Do të largohem që këtu duke pasur një marrëdhënie të mirë me të gjithë, plot respekt të ndërsjellë", ka thënë Emery.

Skuadra e PSG-së gjatë verës së kaluar bëri shpenzime të mëdha duke transferuar Neymarin nga Barcelona dhe Mbappen nga Monaco, por prapëseprapë kjo skuadër u eliminua nga Liga e Kampionëve dhe aty u vendos për largimin e Emerys. Ky i fundit pritet të zëvendësohet nga ish-trajneri i Borussia Dortmundit, Thomas Tuchel.

### Schalke konfirmon largimin e Meyerit

Schalke 04 ka konfirmuar se mesfushori Max Meyer do të largohet nga klubi gjatë kësaj vere. Meyer ka kontratë me Schalcken deri në qershor të këtij viti dhe do të jetë futbollist i lirë për këdo që dëshiron të nënshkruajë me të. Largimin e Meyerit e ka konfirmuar drejtori sportiv i klubit gjerman, Christian Heidel. "Meyer përfundimisht do të largohet nga Schalke këtë verë. Ne jemi duke marrë këtë situatë në mënyrë profesionale. Gjithçka ka qenë shumë miqësore", ka deklaruar Heidel. Futbollistin gjerman e kërkojnë tri skuadrat italiane: Juventus, Milano dhe Roma.

### Candrea: Fitojmë për të shkuar në Ligën e Kampionëve

Prej dy javësh e nis nga stoli, pasi Spalletti ka preferuar aktivizimin e francezit Yann Karamoh në formacion, por duket se në sfidën derbi të Italisë, ndaj Juventusit, Antonio Candrea do të rikthehet të luajë nga fillimi. Sulmuesi anësor italian theksoi se e gjithë skuadra është gati të japë diçka më shumë se 100 %, jo thjesht për ta mposhtur Juventusin, por për të shkuar në Ligën e Kampionëve. "Ka një javë rresht që e thotë Brozoviqi, mezi po presim momentin që të luajmë këtë supersfidë, e cila është shumë e rëndësishme për objektivat tona. Juventusin në vitet e fundit është skuadra më e fortë në Itali, madje edhe në Evropë ka bërë shumë mirë. Do të kemi përballë një Juve të nevrikusur që do të kërkojë me çdo kusht tri pikët, por edhe ne duam fitoren, pasi dëshirojmë të shkojmë në Ligën e Kampionëve dhe nuk kemi rrugë tjetër. Nuk mund të gabojmë asgjë. Do ta japim maksimumin për ta arritur objektivin tonë. Edhe unë personalisht duam të jap diçka më shumë nga vetja për të shkuar në Ligën e Kampionëve", ka thënë Candrea.

"San Siro" do të jetë i tejmbushur për derbin e Italisë dhe Candrea beson se me tifozët, Interi mund t'ia dalë, ndërsa falënderon ata për praninë e madhe në numër, thuajse gjatë gjithë sezonit. "Ne duhet t'i falënderojmë tifozët tanë sepse 'San Siro' ka qenë i mbushur plot gjatë gjithë sezonit. Na kanë përkrahur gjatë gjithë viti dhe këtë sfidë ne duhet të fitojmë për vete, por edhe për tifozët", u shpreh sulmuesi i Interit.

### Cazorla rikthehet pas 17 muajsh

Santi Cazorla ditën e enjte ishte në fushën "Emirates" për të zhvilluar një seancë të lehtë stërvitore. Mesfushori spanjoll herën e fundit që ka luajtur për klubin ka qenë në tetor të 2016-s dhe që prej asaj kohe ka qenë në infermier. 33-vjeçari u është nënshtruar disa operacioneve në kaviljen e djathtë dhe ka humbur tetë centimetra nga tendina, teksa një infeksion rrezikoi ta amputonte këmbën. Një tjetër dëmtim në janar ka vonuar rikthimin e spanjollit por, mesa duket, tani është në rrugën e duhur për t'u riaftësuar 100 %. Ai është stërvitur me një pjesëtar të stafit të Arsenalit dhe, përveç stërvitjes atletike, ka bërë edhe disa ushtrime me topin në këmbë. Një lajm që do t'i ketë kënaqur së tepërmi tifozët e ekipit londinez.



# Lume's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

